

NATURAL
POOL&SPA

@NATURAL POOL&SPA WWW.NATURAL-KS.COM +38348473473 SOJEVË, FERIZAJ

TRAVEL MAGAZINE

DHJETOR 2024 - JANAR 2025

GP
MAGAZINE

AIRPLANE MAGAZINE

GP ORGANIZON
685
FLUTURIME
PËR 60 DITË

REKORDI I RI I
FLUTURIMEVE
nga
PRISHTINA

LIDHIM KOSOVËN
ME BOTËN

REPORTING
HOUSE

VIZITONI MUZEUN "REPORTING HOUSE"

HYRJA FALAS

E MARTË - E SHTUNË | 10:00"-1600" | LOKACIONI: ISH-SHTËPIA E MALLRAVE GËRMIA, TE SKËNDERBEU



20

YEARS TOGETHER



FJALAE BOTUESIT

Të dashur lexues,

Ne besojmë që kur jeni nisur në këtë rrugëtim ju kanë munguar disa nga informacionet që janë brenda kësaj magazine. Në fluturimin tonë të përbashkët, me përkushtimin profesional, kemi përgatitur materiale që ndiqen lehtësisht dhe që ju japin informacione dhe mundësi për të kaluar kohën dhe për të planifikuar festën tuaj.

Prindër të dashur, ne ju kemi ofruar materiale të cilat ju tregojnë për rëndësinë që fëmijët tuaj të mësojnë gjuhën dhe kulturën shqipe. Ekspertët e mirënjohur ju kanë rekomanduar edhe turin turistik për historinë shqiptare. Në rrugëtimin e fëmijëve tuaj, kemi synuar që për më të vegjlit tuaj të ofrojmë përrallën dhe legjendën shqiptare. Një ëndërr e bukur për kreshnikët, orët dhe zanat do të mbetet thellë në kujdesën e fëmijëve tuaj.

Të dashur studentë dhe ju që në Kosovë i planifikoni festat e fundvitit, për ju kemi përgatitur turin informues për festat dhe zonat ku do të keni përjetime të paharruara për festat. Për ju që vini në Kosovë me mendjen për të investuar, kemi përgatitur materiale që tregojnë potencialet ekonomike të vendit dhe mundësitë për të bërë biznes.

Në vizionin tonë editorial është t'ju prekim kërkshërinë tuaj për të eksploruar mundësitë që të investoni dhe të zhvilloni biznesin tuaj. Rrëfimet e bizneseve të suksesshme, që eksportojnë nga Kosova, do të jenë pjesë e pandashme e magazinës sonë.

Kur jemi në ajër, duke fluturuar, të gjithë e kuptojmë sa e vogël është bota, andaj kemi përgatitur një udhërrëfyes të shkurtër për qytetet më të bukura për t'u vizituar gjatë festave të fundvitit. Jo gjithmonë pamjet e bukura të festave dalin në pah në magazinat botërore. Ne do t'ju rekomandojmë të vizitoni fshatrat dhe qytetet më të stolitura të Kosovës gjatë festave të fundvitit. Juve ju mbetet që fotografitë dhe kujtimet t'i ndani me miqtë tuaj dhe t'i promovoni këto nisma të përzgjedhura. Ju urojmë udhëtim të këndshëm!

Gëzuar festat!



Adresa: Prishtinë, Mati 1. nr.31
Tel: + +383 44 326 143
E-mail:service@gp-aviation.net



 TRANSFORMOJMË PREZENCËN TUAJ ONLINE!



 www.pfp-ks.com
 +383 43 899 331



LEXONI NË KËTË NUMËR




10

Lidhim Kosovën me botën, “Zhvillimi i kompanisë që po e lidh Prishtinën me qytetet e Evropës.

12

Ndryshimet e popullsisë në Kosovë, “Qytetet në të cilat pati ndryshime në numrin e popullsisë”.





FAQE 30-33 Pasuritë e Kosovës në ari dhe argjend, “harta e pasurive natyrore të Kosovës”.

FAQE 42-43 Potencialet e investimeve dhe zonat turistike në Shqipëri.

FAQE 50-53 Këndi i mësuesit të diasporës.

FAQE 64-65 Këndi i përrallave të fëmijëve.

FAQE 66-70 Gratë nga Krusha që po e zhvillojnë Kosovën



Mesazh nga gp aviation

*Të dashur udhëtarë të GP Aviation,
Së bashku me ju, kompania jonë po hyn në vitin e pestë të operimit,
me linjat e drejtpërdrejta nga Prishtina në drejtim të botës.*



Mbi vizionin e themeluesit të kompanisë Ganesh Stephan Piga, ne po vazhdojmë të rritemi, duke shtuar numrin e personelit, numrin e operimeve dhe numrin e flotës sonë ajrore.

Vizioni ynë është i qartë: Prishtina do të jetë qendër e operimeve të sigurt dhe të përballueshme ajrore.

Flota jonë ajrore numëron aeroplanë nga Boeing 737-400, Airbus 320, Airbus 319 dhe Boeing 737-400. GP mbyll vitin 2024 me numrin më të madh të operimeve në historinë e saj dhe me një rekord prej udhëtarësh. Viti 2025 do të jetë vit i rekordeve të reja. Gëzuar!

FMO
Prishtinë
disa herë në javë

FMO

**FLUGHAFEN
MÜNSTER
OSNABRÜCK**

Promobi

www.promobi-ks.com



NEW ARRIVALS

Ofertat më të mira
për interier modern!

Magjistralja Ferizaj - Prishtinë

+38345999102

+38344478660



Jepni një dizajn unik shtëpisë tuaj me mobiljet tona të cilat i sjellim për ju kudo në Europë!

thirr.com

INTERNETI MË I MIRË 5G PËR KOSOVË & EUROPË

AKTIVIZOJE eSIM ONLINE OSE TEK PIKA NË AEROPORT (TEK DALJA)

PAKO EUROPA+

FUNKSIONON NË 80+ SHTETE



1GB

3⁴⁹€

15 DITË

3GB

8⁴⁹€

30 DITË

6GB

13⁹⁹€

30 DITË

12GB

18⁹⁹€

30 DITË

20GB

29⁹⁹€

30 DITË

30GB

39⁹⁹€

30 DITË

30GB

59⁹⁹€

180 DITË

50GB

99⁹⁹€

365 DITË

Udhëto pa brenga me pakot PALIMIT

19⁹⁹€

3 DITË

29⁹⁹€

7 DITË

44⁹⁹€

30 DITË

FESTAT E DHJETORIT NË MBARË GLOBIN

Festimi i Vitit të Ri dhe krishtlindjeve është njëra nga ndërmarrjet më të mëdha të organizimit të festave në mbarë globin.

Miliona turistë lëvizin për të vizituar spektaklet në mbarë globin, të organizuara për këto festa.



TIRANA

Shqipëria shndërrohet në një zonë atraktive për festat e fundvitit. Në qytetet e vendit, përfshirë Shkodrën, Korçën, Vlorën etj., organizohen festime në sheshet kryesore të qytetit dhe hapësirat publike. Epiqendra e festës është në sheshin "Skënderbe", në Tiranë. Sheshi shndërrohet në një qendër festive, me fishekzjarrë dhe koncerte live. Në hapësirat e këtij sheshi vizitorët mund të shijojnë ushqimet dhe pijet e zonës në një atmosferë të mirë festive.

VIZITO AUSTRALINË

Pa dyshim të gjithë njerëzit e kujtojnë Sidney, si lajmin e parë për Vitin e Ri. Ora globale tregon se Viti i Ri arrin për herë të parë në Australi dhe Sidney ofron spektaklin e parë të fishekzjarrëve në botë. Qyteti hap Vitin e Ri me fishekzjarrë të famshëm mbi Harbour Bridge dhe Opera House. Ky spektakël ndiqet nga mijëra vizitorë dhe miliona ndjekës në transmetimet e drejtpërdrejta televizive.



VIZITO LONDRËN

Pa dyshim, në mesin e vendeve të rekomanduara janë vizita në Londër dhe spektakli në këtë qytet është i fokusuar në Thames River dhe rrota ikonike "London Eye". Aty ofrohet një pamje madhështore, me fishekzjarrët që ndriçojnë qiellin mbi Londër.



VIZITO EVROPËN

Festat e fundvitit në mbarë Evropën janë të këndshme dhe me shumë befasi. Shumica e kryeqyteteve evropiane kanë organizime speciale për këtë festë, ndërsa në secilën zonë janë ndarë hapësirat e veçanta të festimeve.



VIZITO BERLININ

Gjermania në fund të vitit është e njohur për ofertat e lira të blerjes dhe shumë atraksione në festime. Pa dyshim, epiqendra e festës është kryeqyteti, Berlini, pasi zona përreth portës së Brandenburgut bëhet qendra e festimeve, me fishekzjarrë dhe festa masive.

VIZITO ROMËN DHE VATIKANIN

Krishtlindjet në Vatikan janë një nga ngjarjet më të rëndësishme dhe më të bukura në kalendarin liturgjik dhe kulturor të Selisë së Shenjtë. Vizitorët kanë mundësi të ndjekin meshën e krishtlindjeve në Bazilikën e Shën Pjetrit më 24 dhjetor dhe stolisjen e Selisë së Shenjtë me bredhin e krishtlindjeve. Pjesa tjetër e zonës dhe qyteti i Romës janë po ashtu atraktive për organizimet gjatë festave të fundvitit.



VIZITO PARISIN

Franca njihet për festime masive dhe stolisje në detaje të qyteteve gjatë festave të fundvitit. Qyteza e Kolmar është një nga zonat më të bukura që vizitohet nga miliona turistë gjatë festave të fundvitit. Qyteza e vjetër stoliset skajshmërisht nga dritat dhe pemët e krishtlindjeve. Edhe në kryeqytetin e Francës, në Paris, vizitorët magjepsen çdo vit nga ndriçimet festive në Champs-Élysées dhe spektaklin e dritave në Kullën Eiffel.

NEW YORK

Në shtetet e Bashkuara të Amerikës festat e fundvitit karakterizohen me organizime masive të stolisjes së shtëpive dhe qyteteve. Në kulturën amerikane secila shtëpi stolis oborrin dhe hapësirat brenda shtëpive me dritat dhe pemët e krishtlindjeve. Organizimi më i madh në SHBA realizohet në qytetin e New York-ut. Sheshi "Times Square" është i famshëm për rënien e "Topit të Kristaltë" dhe koncertet madhështore.



RIO DE JANEIRO

Festat e fundvitit janë në qendër të vëmendjes edhe për organizimet në Brazil, në kryeqytetin Rio de Janeiro. Plazhi "Copacabana" është i njohur për fishekzjarrët e jashtëzakonshëm dhe festimet në natyrë.

DUBAI

Në vitet e fundit, Emirate e Bashkuara Arabe janë bërë lajm botëror për festimet e Vitit të Ri. Dubai është shndërruar në një zonë atraktive, me festime dhe fishekzjarrë nga kullat e larta të qytetit.



STAMBOLLI

Viti i Ri në Stamboll është një eksperiencë magjike dhe plot gjallëri! Qyteti, që tashmë është një përzierje fantastike e traditës dhe modernitetit, ofron një atmosferë unike gjatë festimeve të ndërrimit të viteve. Ja disa nga gjërat që mund të përjetoni në Stamboll për Vitin e Ri. Një nga vendet më të mira për të parë fishekzjarrët është pranë Bosforit. Ju mund të zgjidhni një udhëtim me jaht në Bosfor dhe të shijoni pamjet mahnitëse të dritave mbi ujë.



LIDHIM KOSOVËN ME BOTËN

Kosova ndërtoi njërin nga aeroportet më të mira në Rajonin e Ballkanit. Infrastruktura moderne e ANP-së dhe shpejtësia e operimit krijojnë mundësinë e zhvillimit të kompanive ajrore lokale, të cilat bazën e operimit e kanë nga ANP drejt destinacioneve të botës.

Si operuesi më i madh i Aeroportit të Prishtinës, GP Aviation ka planifikuar lidhjen rekorde të fluturimeve në festat e fundvitit.

Brenda 60 ditëve të festave, nga ANP-ja GP planifikon të realizojë 685 fluturime në destinacionet më të populluara të mërgatës dhe turistëve që udhëtojnë drejt Kosovës dhe anasjelltas.


Me aeroplanët tanë, të teknologjisë së lartë dhe të certifikuar në cilësi, do të synojmë të japim kualitetin maksimal në shërbimet ajrore.

Pilotët tanë do të garantojnë udhëtim të rehatshëm dhe me saktësinë

“

Brenda 60 ditëve të festave, nga ANP-ja GP planifikon të realizojë 685 fluturime në destinacionet më të populluara të mërgatës dhe turistëve që udhëtojnë drejt Kosovës dhe anasjelltas.

”



- ✈ **BAZEL 112 FLURIME**
- ✈ **CYRIH 92 FLUTURIME**
- ✈ **GJENEVE 31 FLUTURIME**
- ✈ **DYSELDORF 102 FLUTURIME**
- ✈ **SHTUTGARD 95**
- ✈ **MYNHEN 61**
- ✈ **MEMINGEN 29**
- ✈ **NUREMBERG 26**
- ✈ **MYNSTER 35**
- ✈ **BERLIN 17**
- ✈ **HAMBURG 15**
- ✈ **HANOVER 15**
- ✈ **HALMSTAD 18**
- ✈ **LUKSEMBURG 16**
- ✈ **LUBJANË 7**

maksimale të operimit.

Stafi ynë i shërbimit, i përbërë kryesisht nga stafi lokal, i certifikuar ndërkombëtarisht, do t'ju shërbejë në gjuhën dhe në zakonet tona. Në menynë tonë të udhëtimit do të shijoni prodhimet cilësore "Made in Kosova" dhe do të mund të gëzoni miqtë me dhuratat me histori nga vendlindja.

Asistenca jonë e drejtpërdrejtë dhe në linjat telefonike do t'ju shërbejë 24 orë, 7 ditë në javë, në gjuhën shqipe dhe me mirësjelljen maksimale.

Bëhuni pjesë e udhëtimeve tona drejt qyteteve të Evropës. Në dhjetor dhe në janar GP do të lidhë

Kosovën me Zvicrën, me plot 235 fluturime direkte: Gjermaninë me 395 fluturime direkte, Luksemburgun me 16 fluturime direkte dhe Slloveninë me 7 fluturime direkte.

Me GP rrugëtimin tuaj festiv drejt Kosovës, apo drejt Evropës, do të vazhdoni ta keni të lirë, komod, të sigurt dhe më e rëndësishmja në kohën e përcaktuar. Me linjat tona, të shumëfishta, ju do të mund të përshtatni secilin plan dhe orar tuajin gjatë festave të fundvitit.

SI NDRYSHOI POPULLSIA E KOSOVËS

Gjatë vitit 2024, Agjencia e Statistikave të Kosovës e ka kryer regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë në Kosovë.

Të dhënat e publikuara nga kjo agjenci tregojnë për ndryshim të shifrave të popullsisë në gjithë vendin.

Sipas të dhënave të publikuara, në Kosovë jetojnë 1,586,659 banorë, prej tyre 795,046 meshkuj dhe 791,614 femra.

Agjencia i ka krahasuar të dhënat edhe me regjistrimin e vitit 2011. Këto të dhëna tregojnë se në 29 komuna pati zvogëlim të popullsisë, derisa në 9 komuna rritje të popullsisë.

Në Prishtinë dhe në Ferizaj numri i banorëve është rritur në krahasim me vitin 2011, ndërsa në pesë komunat e tjera: Gjilan, Mitrovicë, Prizren, Pejë, Gjakovë popullsia është zvogëluar.

Këto janë statistikat e komunave më të mëdha dhe ndryshimet në numrin e banorëve krahasuar me vitin 2011.

Në vijim gjeni shifra krahasuese të numrit të popullsisë në qytetet më të mëdha në krahasim me regjistrimin e vitit 2011, sipas të dhënave nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.

PRISHTINË

Regjistrimi i vitit 2011: 198,897 banorë

Regjistrimi i vitit 2024: 227,154 banorë

MITROVICË E JUGUT

Regjistrimi i vitit 2011: 71,909 banorë

Regjistrimi i vitit 2024: 64,680 banorë

GJILAN

Regjistrimi i vitit 2011: 90,178 banorë

Regjistrimi i vitit 2024: 82,901 banorë

PEJË

Regjistrimi i vitit 2011: 96,450 banorë

Regjistrimi i vitit 2024: 82,661 banorë

FERIZAJ

Regjistrimi i vitit 2011: 108,610 banorë

Regjistrimi i vitit 2024: 109,345 banorë

GJAKOVË

Regjistrimi i vitit 2011: 94,556 banorë

Regjistrimi i vitit 2024: 78,824 banorë

PRIZREN

Regjistrimi i vitit 2011: 177,781 banorë

Regjistrimi i vitit 2024: 147,428 banorë



*Ofertë fantastike
skandinave për të gjithë
brenda jetesës dhe
gjumit*

JYSK është një rrjet ndërkombëtar i mobilimit të shtëpisë me rrënjë skandinave që e bën të lehtë mobilimin e ambienteve në çdo shtëpi dhe kopsht, duke sjellur atmosferë skandinave që i'u jep një eksperiencë frymëzuese të blerjes me një dizajn minimalist dhe elegant.



Porosit online në **JYSK-ks.com** apo vizito dyqanet tona.
JYSK Prishtinë, JYSK Albi Mall, JYSK Royal Mall,
JYSK Prishtina Mall, JYSK Arbëri, JYSK Pejë, JYSK Prizren,
JYSK Ferizaj, JYSK Gjilan, JYSK Gjakovë.



ORIGJINA E KAPELËS SIMBOLIKE TË SHQIPTARËVE



Qeleshja e bardhë, apo plisi, është kapela simbol në kokën e burrave shqiptarë. Plisi, që në kohërat e vjetra bartej nga burrat, sot është shndërruar në një simbol nacional, i cili mbahet në kokë me krenari gjatë festave dhe përdoret për të ilustruar trimërinë dhe përkatësinë kombëtare.

Plisi është një kapelë tradicionale, e bardhë, prej leshi, që zakonisht ka formën e rrumbullakët ose gjysmësferike. Ai është përdorur për shekuj me radhë nga burrat shqiptarë dhe mbart një simbolikë të fortë kombëtare dhe kulturore.

Origjina dhe evolucioni

Origjina e saktë e plisit nuk është e dokumentuar qartë, por arkeologët dhe historianët sugjerojnë se ai mund të ketë lidhje me kokoret e lashta, të përdorura në Rajonin e Ballkanit. Disa e lidhin me periudhën ilire, duke parë se figurat dhe statujat e ilirëve shpesh përshkruhen me një lloj kapele të ngjashme.

Përdorimi i plisit ka mbetur i qëndrueshëm gjatë periudhave të ndryshme historike, pavarësisht ndryshimeve politike dhe kulturore në rajon. Gjatë Perandorisë Osmane, plisi ishte një simbol i identitetit shqiptar dhe qëndresës ndaj asimilimit kulturor.

Përdorimi dhe simbolika

Plisi shpesh shihet si një shenjë e pastërtisë, thjeshtësisë dhe lidhjes me natyrën dhe traditat. Ngjyra e bardhë simbolizon pastërtinë shpirtërore dhe fisnikërinë. Në disa raste, ai përfaqëson unitetin dhe identitetin kombëtar shqiptar.

- Në Veri të Shqipërisë: Forma e plisit është më e lartë dhe më e ngushtë, duke u dalluar nga varianti i përdorur në Kosovë.
- Në Kosovë: Plisi është më i ulët dhe i gjerë.
- Në traditat kulturore: Plisi shpesh shoqërohet me veshjet tradicionale të burrave dhe përdoret në raste festive, ceremoni dhe ngjarje të rëndësishme.

Statusi i sotëm

Në ditët e sotme, plisi përdoret kryesisht në ceremoni tradicionale, festivale dhe si simbol i trashëgimisë kombëtare. Ai vazhdon të mbetet një element unik që dallon shqiptarët nga kulturat e tjera. Plisi është, gjithashtu, një simbol krenarie dhe përfaqësimi për diasporën shqiptare në mbarë botën.

Prodhimi i plisit

Baza e prodhimit të plisit është leshi i bardhë i deleve.

Procesi fillon me përzgjedhjen e leshit cilësor, zakonisht nga delet lokale. Ky lesh pastrohet dhe përgatitet për punim. Leshi fillimisht shtypet për t'u bërë i butë dhe i njëtrajtshëm. Pasi përpunohet, formohet një masë e njëtrajtshme që përgatitet për formësim. Forma tradicionale e plisit bëhet duke përdorur mjete të posaçme, prej druri ose prej metali. Leshi shtypet dhe formohet në këtë kornizë, duke u siguruar që të ketë formën e duhur të rrumbullakët dhe të ngushtë në bazë.

Plisi ngjishet për t'i dhënë strukturën e tij të qëndrueshme. Më pas lihet të thahet, në kushte të kontrolluara, për të siguruar që të mbajë formën.



KËSHILLA PËR JETËN E NATËS NË PRISHTINË

Siguria

Prishtina është në mesin e qyteteve më të sigurta në Ballkan. Brenda qytetit janë katër stacione të policisë dhe në netët me ngarkesë policia shton prezencën përreth zonave ku grumbullohen njerëzit.

Siguria në ambientet e natës

Prishtina njihet si qytet me klientelë të qetë dhe njerëz që nuk krijojnë probleme gjatë natës. Për shkak të sigurisë së lartë në hyrjet e bareve dhe kafeneve, nuk ka njerëz që merren me sigurimin. Në diskotekat dhe pubet e qytetit kompani private të sigurimit kujdesen për rendin shtëpiak.

Rezervo paraprakisht

Në ditët kur të gjithë janë jashtë, mundësia për të siguruar një tavolinë apo karrige të lirë në baret dhe kafenetë e qytetit është e vështirë. Pjesa më e madhe e kafeneve funksionojnë me rezervime paraprake, të cilat duhet të kryhen disa orë para daljes. Në shumicën e rasteve rezervimet janë falas. Pagesat për rezervime bëhen në diskoteka.

Transporti

Prishtina ka taksitë të lira, të cilat punojnë 24 orë. Për shkak të distancave të largëta prej kafeneve deri te diskotekat, është i domosdoshëm përdorimi i makinave. Për personat që nuk konsumojnë alkool, makinat janë zgjidhje. Skaj bareve dhe diskotekave ka parkingje me pagesë. Për konsumuesit e alkoolit, i vetmi transport i rekomandueshëm janë taksitë. Prishtina njihet si vendi me shërbime të lira të taksisë, të cilat në maksimum gjatë natës mund të shkojë deri në 5 euro.

Pijet dhe ushqimi

Shumica e bareve dhe kafeneve shërbejnë birrë draft, ndërsa në meny kanë nga 5 deri 10 lloje birrash. Banakierët e Prishtinës janë të edukuar për përgatitjen e koktejeve, ndërsa një pjesë e madhe e bareve shërbejnë meze të çastit, që rekomandohen për vizitorët.

Mos harro hamburgerët e mëngjesit

Për gurmanët e ushqimit, Prishtina njihet si qyteti i hamburgerëve të mëngjesit. Në disa zona të qytetit ndjekësit e jetës së natës, në rrugën e kthimit për në shtëpi, i shijojnë hamburgerët tradicionalë të qytetit. Çmimet e hamburgerëve janë të lira dhe afër zonave ka parkingje.



REKLAMO BIZNESIN NË AEROPORTIN E PRISHTINËS ME OFERTËN MË TË MIRË!

www.pfp-ks.com
+383 43 899 331



MËNGJESET E VIKENDIT NË PRISHTINË

Kur dielli ndriçon Prishtinën, në vikend qyteti mbushet me qytetarë. Ndjenja më e mirë është kur e nuhat aromën e kafesë. Prishtina njihet për kafe të mirë, sidomos për makiato.

Vikendi në kryeqytet e ka rutinën e tij: një mëngjes me familjarë ose me shoqëri në vendet më të ngrohta. Në çdo lagje ka kafene të njohura për qytetarët, duke filluar nga “Bregu i Diellit”, ku ndodhet “Sonder”. Kafeneja njihet për mëngjesin me bagels, sallata dhe shakshuka, me shumëllojshmëri edhe të ushqimeve vegjetariane dhe vegane.



Po në këtë lagje ndodhet furra “Artizan”, të cilën qytetarët e pëlqejnë për llojlojshmërinë e bukëve, nga ato me brumë të thartë dhe ato franceze deri te kroasanët e famshëm.



Në qendër të qytetit, përball “Grand Hotel”, ndodhet “Metro”, një nga kafenetë më të vjetra të kryeqytetit. Të gjithë i pëlqejnë sallatat dhe sandviçet unikë që ky vend i ofron.



“Churchill” është një tjetër kafe/bar i pëlqyer në Prishtinë. Menyja përmban ushqime më ndryshe krahasuar me vendet e tjera dhe njihet edhe për përgatitjen e koktejeve me receta origjinale të lokalit. Ngjyrat bardhë dhe kaltër e karakterizojnë ambientin, kurse tarraca është eksperiencë më vete kur ngroh dielli.



Në rrugën e njohur “Fehmi Agani” ndodhet edhe “Rita’s Caffè & Bar”, një lokal i ri në Prishtinë. Më së shumti njihet për sandviçet me bukë fokaçe dhe pastat.



Në të njëjtën rrugë ndodhet dhe “Tartine Deli”. Nëse dëshironi të ëmbëlsoni mëngjeset tuaja, atëherë me patjetër duhet t’i provoni ëmbëlsirat e “Tartine”. Prishtina ofron shumë e shumë kafene, në të cilat ju do të ndiheni rehat, si në shtëpinë tuaj. Këto janë vetëm disa nga shumë vendet e tjera të njohura, të cilat bëjnë bashkë vendës dhe të huaj.



TRANSPORT

PËR MALLËRA DHE AUTOMOBILË

KOSOVË
ZVICËR
KOSOVË

SHËRBIMET:

- ✓ Përvojë shumëvjeçare
- ✓ Profesionalizëm
- ✓ Siguri maksimale
- ✓ Kapacitete të mëdha
- ✓ Infrastrukturë moderne
- ✓ Çmime konkurruese



KONTAKT:

Zvicër: +41 76 700 2121, +41 79 640 1306
Kosovë: +383 44 336 987, +383 49 227 200

PJETËRSHANI, FSHATI I STOLISUR I GJAKOVËS QË KONKURRON BOTËN



Një komunitet i vogël i banorëve të Pjetërshaint të Gjakovës shndërrohen në lajm çdo vit në Kosovë. Me vetiniciativë banorët stolisin fshatin për festat e fundvitit, duke e shndërruar Pjetërshanin në fshatin më të stolisur në Kosovë.

Nisma e banorëve, e kopjuar nga shumë komunitete të tjera në Evropë, është shndërruar në atraksion për vizitorët lokalë, ndërsa banorët premtajn që stolisja e vitit 2024 do të jetë më madhështorja.

“ Palush Nikolla, njëri nga organizatorët e kësaj iniciative, e cila e ka kthyer fshatin Pjetërshani në destinacion turistik për festat e fundvitit, tregon se tashmë i kanë nisur përgatitjet që më datën 1 dhjetor të jetë gjithçka gati për t`u ndezur dritat.

Ai tregon se këtë vit pritet që stolisja e fshatit të jetë edhe më madhështore dhe se presin edhe më shumë vizitorë, anekënd Kosovës, përfshirë mërgatën, e cila për festat e fundvitit kthehet në Kosovë.

“Këtë vit presim që i gjithë aktiviteti të jetë edhe më madhështor, edhe më i ngrohtë për të gjithë ata qytetarë e bashkatdhetarë që do të vijnë në Pjetërshani, për të vizituar nga afër pjesën të cilën ne tashmë e kemi kthyer në traditë, duke e stolisur për festat e fundvitit”, tregon Palush Nikolla.

Nikolla thotë se tashmë i kanë filluar përgatitjet në bashkëpunim me Kishën e Pjetërshanit dhe me rininë për ta stolisur fshatin.

Ai thotë se dekorimet këtë vit do të jenë më





madhështore, pasi zona e ndriçuar do të zgjerohet.

“Këtë vit jemi duke u përgatitur që dekorimet të jenë edhe më madhështore. Presim që ta zgjerojmë zonën e stolitur me ndriçime, që këtë vit kemi planifikuar t’i vendosim edhe më vezulluese”, tregon ai.

Nikolla thotë se, sikurse vitet e kaluara, ky aktivitet, që tashmë është shndërruar në tradicional, i tëri realizohet në mënyrë vullnetare dhe me kontributin e banorëve vullnetmirë.

Sipas tij, njëjtë sikurse vitet paraprake, ata synojnë dhe janë të vendosur që i gjithë ky aktivitet të mos kthehet asnjëherë në komercial.

“Ne edhe kësaj radhe jemi të vendosur që ky aktivitet të mbetet kështu, siç ka qenë, me bazë vullnetare do të shkojë gjithçka. Synimi ynë dhe vendosmëria është që ta ruajmë nga komercialja”, tregon ai.

Ai shton se të gjithë qytetarët që do ta vizitojnë këtë fshat do të mund të shërbehen me çaj të ngrohtë, çokolatë të ngrohtë dhe verë.

“Këtu, që tashmë mund ta quaj festival, do të ofrohen vetëm verë, çaj dhe çokolatë e ngrohtë. Nuk duam ta kthejmë në diçka komerciale, sepse mund t’i humbë kuptimi. Që në fillim kemi menduar se mjafton që njerëzit ta ndiejnë ngrohtësinë e fshatit të zbukuruar, magjinë e festave të fundvitit. Pra, festën e Krishtlindjeve dhe pastaj ndërrimin e motive”, tregon ai.

Ai kujton kohën kur nisi të dekorohet fshati nga të rinjtë.

“Nuk e kemi menduar se kjo do të shndërrohet në

diçka të njohur dhe që do të na vizitonin kaq shumë njerëz, mirëpo kujtoj që mediat kanë luajtur rol të veçantë, duke ndikuar që fshati Pjetërshan të njihet tashmë për këtë organizim”, thotë Nikolla.

Ai tregon se të gjitha mjetet, me të cilat ata e dekorojnë fshatin, janë kontribut i vetë banesorëve dhe asnjëherë nuk janë ndihmuar nga ndonjë institucion publik, qoftë ai i nivelit qendror apo lokal.

“ Nikolla tregon se gjatë muajit dhjetor, sa zgjat ky organizim, kanë bashkëpunim shumë të mirë me Policinë e Kosovës, e cila, sipas tij, kujdeset në çdo kohë që gjithçka të shkojë mirë edhe sa i përket aspektit të sigurisë dhe rregullit në komunikacion përreth zonës.

“Ne do ta vazhdojmë këtë traditë. I falënderoj njerëzit vullnetmirë, të rinjtë e fshatit, djem e vajza, të cilët përreth një muaj vullnetarisht ndihmojnë në përgatitjen për ndriçimin e fshatit. Ne e rregullojmë oborrin e Kishës së fshatit, një pjesë të fshatit”, tregon ai.

Nikolla tregon që fshati për festat e fundvitit është vizituar edhe nga ambasadorë të vendeve të BE-së dhe shumë personalitetet nga jeta politike e vendit.

Gjatë mbrëmjeve Nikolla thotë se edhe këtë vit do të ketë muzikë të gjallë, po ashtu mbi bazën vullnetare, nga muzikantë të ndryshëm.



RRUGËTIMI I ARTIT TË MODËS NGA KOSOVA DREJT BOTËS

Një brez i ri i disenjatorëve po ndërton një të ardhme të re dhe të guximshme për industrinë e modës në Kosovë. Ata po inspirohen nga kultura lokale dhe ajo ndërkombëtare, për të krijuar koleksione që pasqyrojnë jo vetëm estetikën, por edhe vizionin e një shoqërie që po ndryshon. Moda mori një hov të madh në Prishtinë, e besa në tërë Kosovën, në vitet 2000. Disenjatorët e parë në Prishtinë, megjithëse kanë pasur kushte të vështira për të zhvilluar karrierën e tyre, arritën të krijojnë hapësirën për të ndihmuar në ngritjen e industrisë së modës në qytet dhe në rajon.

Prishtina sot ka një skenë mode që po rritet dhe po zhvillohet, me disenjatorët e saj që luajnë një rol të rëndësishëm në këtë transformim.

Moda në Prishtinë ka kaluar një transformim të dukshëm gjatë dekadave të fundit, duke u zhvilluar në një industri të njohur dhe të respektuar, si brenda vendit, ashtu edhe jashtë. Disenjatorët e rinj po sjellin një frymë inovative dhe të guximshme, duke kombinuar traditën me trendët moderne. Kjo skenë e re, me influencë ndërkombëtare dhe një përqendrim të fortë në identitetin kulturor, do të vazhdojë të zhvillohet dhe të krijojë mundësi të reja për talentet e së ardhmes.



VALDRIN SAHITI është një nga emrat më të njohur të modës në Prishtinë dhe më gjerë. Ai ka prezantuar koleksionet e tij në pasarelat më të rëndësishme, si në Prishtinë, në Tiranë, dhe në disa qytete të tjera të Evropës.

Sahiti është i njohur për dizajnimin e veshjeve, të cilat përfshijnë detaje të sofistikuara, tekstura luksoze dhe linja elegante që pasqyrojnë një ndjesi moderne, por pa e harruar traditën. Ka realizuar bashkëpunime me figura të njohura dhe ka veshur disa nga personazhet më të famshëm, siç janë Beyonce dhe motrat Kardashian, që i ndihmuar për të rritur profilin e tij në industrinë ndërkombëtare të modës.



TEUTA MATOSHI, një tjetër disenjatore e njohur vjen nga Prishtina, veshjet e së cilës karakterizohen nga një kombinim i elegancës dhe thjeshtësisë. Ajo krijon koleksione që janë të pranueshme për femrat e çdo moshe, duke u dhënë atyre mundësinë të shprehin individualitetin e tyre përmes modës.

Pasionin për modën Matoshi e ka trashëguar edhe te motra e saj, Lirika Matoshi, e cila bëri që bota t'i kthejë sytë nga ajo kur realizoi getat e qëndisura me lule, kjo bëri që të njihet edhe ndërkombëtarisht. Ajo krijon veshje që pasqyrojnë elegancën dhe luksin, duke përdorur ngjyra të forta dhe motive që kanë rrënjë në kulturën shqiptare, duke i përshtatur ato me stilin bashkëkohor.

thirr.com

INTERNETI MË I MIRË 5G PËR KOSOVË & EUROPE
AKTIVIZOJE eSIM ONLINE OSE TEK PIKA NË AEROPORT (TEK DALJA)

199€

BLERINA KLLOKOQI-RUGOVA

është një nga disenjatorët më të suksesshme dhe të njohura të Kosovës.

Kllokoqi-Rugova është e njohur për dizajnimin e veshjeve për ngjarje speciale, si dasma, mbrëmje gala, dhe evenimente të tjera formale. Së fundmi disenjatorja ka krijuar edhe brendin "Bukur", ku dominojnë veshjet e përditshme për të dy gjinitë.

E veçanta e këtij brendi është përdorimi i printeve me objekte dhe fotografi nga vendeve të Kosovës.



NADIRA KIKA hapi atelenë e saj në vitin 2015 dhe nga ajo ditë Kika njihet për prerje dhe qepje, për të kualiteti është shumë i rëndësishëm.

Labentinë Shala është po ashtu e re në industrinë e modës, por puna e saj në "slow fashion" dhe me nismën "zero-waste" ka bërë që veshjet e saj të pëlqehen edhe ndërkombëtarisht. Shala ka marrë pjesë me sfilatë edhe në Sydney të Australisë.

Veshjet minimaliste, me prerje asimetrike, janë një element që duhet ta kemi në gardërobë.



FLUTURA DEDINJA, unike në stil dhe e njohur për dizajnet e saj të rafinuara dhe fustanet e mbrëmjes. Ajo përdor materiale cilësore dhe krijon modele që shquhen për elegancën dhe thjeshtësinë. Dedinja përdor teknika interesante për veshjet e saj, të cilat pëlqehen nga disenjatorët e rinj.

Dedinja vitet e fundit e ka hapur edhe kursin e saj të rrobaqepësisë. Kombinimi i ngjyrave në mënyrë jo të zakonitë ka bërë që Dedinja pëlqehet edhe në vendet e rajonit.

Solistet e muzikës klasike në Kosovë preferojnë dizajnet e Dedinjës për fustanet gala.



FESTIM ISUFI është një tjetër disenjator i ri, por që njihet për elegancën që sjell në fustane dhe për punën kualitative.

Isufi është autor edhe i librit për prerje, "Cardinal Womans Wear", të cilin studentët e rinj të dizajnit të modës e kanë gjetur shumë të dobishëm gjatë studimeve.

KRENARE RUGOVA pa diskutim është emër revolucionar në industrinë e modës në Kosovë. Rugova përdor materiale të guximshme dhe eksperimenton me prerje të ndryshme, duke krijuar veshje që shpesh dallohen për stilin e tyre artistik.

Rugova e filloi brendin e saj në vitin 2003 në Prishtinë, duke sjellë një frymë të re në vend nga New Yorku, ku dhe i ka përfunduar studimet. Ajo ka krijuar edhe laboratorin e quajtur "KR LAB", i cili është i specializuar në tezgjahët me dizajn të krijuar nga kompjuteri, të endura me dorë.

E kur flasim për gjeneratën e re të disenjatorëve në Prishtinë, janë disa emra që vlen të përmenden, si Diana Qërimi, e cila e filloi karrierën e saj në një garazh të vogël afër shtëpisë, e tani së fundi fustanet e Dianës u veshën nga Jenifer Lopez.



Në kuadër të disenjatorëve të rinj, me bazë në Prishtinë, është edhe **NITA BLLACAKU**, e cila për industrinë njihet si disenjatorja "cool". Bllacaku anon në stilin avangardë, minimalist dhe elegant. Koleksionet e saj përfshijnë veshje solemne dhe të përditshme, detajet punë dore çdoherë bien në sy te krijimet e saj.





KOMPANIA QË U NGRIT MBI PRODHIMIN E PATATES

Në vitin 1991, familja Kasumi, nga Pestova e Vushtrrisë, nisi biznesin familjar të prodhimit të patates.

Vushtrria është në mesin e zonave me prodhimtarinë më të madhe të patates në Kosovë dhe familja nisi të prodhonte patatën, e cila atëkohë i dedikohet kryesisht tregut vendor.

Biznesi i vogël familjar u rrit ndër vite me rritjen e sipërfaqeve të mbjella dhe prodhimit të patates.

Lufta e vitit 1999 gjuhëzoi tërë infrastrukturën e ndërtuar të ndërmarrjes së patates. Depot dhe makineria e zonës u dogjën, ndërsa biznesi rifilloi nga zero.

Nga prodhimi i patates në industrinë e çipsave

Në vitin 2004, Kosova prodhonte masovikisht patate, të cilat nuk mund të konsumoheshin nga tregu vendor.

Pjesa më e madhe e prodhimeve finale, përfshirë patatet, importoheshin nga jashtë.

Kompania "Pestova" atëkohë nisi procesin e ndërtimit të një minifabrike për prodhimin e çipsit të patates.

E lansuar në vitin 2004, kompania mori hapa të shpejtë dhe klientelë të mirë në treg.

Historiku i kompanisë tregon se zhvillimi më i madh i saj ndodhi në vitin 2010, kur kompania instaloi dy linja moderne të prodhimit të çipsit.

Që nga ajo kohë e deri më sot, VIPA CHIPS është në mesin brendeve më të shitura të çipsit në Kosovë, ndërsa prodhimet eksportohen në disa vende të BE-së dhe të rajonit. Tani kompania prodhon 28 produkte finale të çipsave dhe produkteve të tjera.

Kontrolli i cilësisë

Për t'u vendosur në tregun evropian, kompania i zbaton në përpikëri standardet e prodhimit dhe kontrollit të cilësisë.

"Pestova" është e përkushtuar në aplikimin e praktikave më të mira për prodhimin e ushqimit, sipas standardeve GLOBALGAP, HACCP dhe ISO 9001:2008. Standardet GLOBALGAP garantojnë që patatet e prodhuara janë të sigurta dhe të kultivuara në mënyrë të qëndrueshme, sipas standardeve të Unionit Evropian. HACCP është sistem, i cili i identifikon rreziqet specifike dhe rregullon masat për kontrollimin e tyre, për të siguruar cilësinë dhe sigurinë e ushqimit. ISO 9001:2008 përcakton procedurat për një sistem të menaxhimit cilësor të kompanisë. Si rezultat, kompania tregon aftësinë e saj për të ofruar vazhdimisht produkte që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve, si dhe synon që ta rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm.

Ndër të tjera, kompania ofron mbështetje të zhvillimit të bujqësisë lokale duke inkurajuar fermerët e rajonit ku ka ofruar kontrata për bashkëpunim në sipërfaqet e mbjellura me patate. Kjo u ka mundësuar fermerëve të kenë një burim të qëndrueshëm të ardhurave dhe të sigurojnë një treg për prodhimet e tyre. Krahas kësaj kompania siguron furnizim të qëndrueshëm me fare të patates të cilësisë së lartë. Ky model bashkëpunimi ka qenë i dobishëm për të dyja palët, duke forcuar lidhjet me komunitetin lokal dhe duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit bujqësor në vend duke garantuar produkte të cilësisë së lartë për prodhimin e çipsit.

vipa



SHIJE TË PAREZISTUESHME

Vipa Chips gjithmonë pranë jush!



“ZONE CLUB” DESTINACION LEGJENDARI JETËS SË NATËS

“Zone Club” në Prishtinë është një destinacion legjendar i jetës së natës, me mbi një dekadë histori në ofrimin e argëtimit të jashtëzakonshëm.

I njohur për mikpritjen e DJ-ve dhe artistëve më të njohur, klubi ofron stile muzikore të larmishme dhe performanca të paharrueshme. Pajisjet më të mira të zërit dhe ndriçimit krijojnë një atmosferë mbresëlënëse për të ftuarit vendas dhe ndërkombëtarë.

Dekorim Sahiti, njëri nga pronarët shpjegon risitë pse Zone është një prej atraksioneve më të mira të Prishtinës.

Ai tregon që klubi ka për qëllim promovimin e kulturës, ndërsa përmes organizimit të eventeve ndërkombëtare me artistë të njohur globalisht, “Zone” e ka vendosur Kosovën në hartën e festivaleve dhe klubeve evropiane.

“Zone” ka krijuar lidhje me klube dhe festivale të njohura në Europë dhe më gjerë, duke sjellë artistë të famshëm dhe duke promovuar Kosovën si një destinacion për argëtimin e tyre”- thotë Sahiti.

Ai tregon se “Zone”, duke ndjekur dhe integruar trendet globale të muzikës, por, gjithashtu, duke ruajtur stilin ka krijuar një identitet unik përmes eventeve cilësore, duke filluar nga investimi në dizajnin e brendshëm e të veçantë. Krijon një ambient që fton dhe inspiron të gjithë adhuruesit e muzikës dhe me



sjelljen e DJ dhe artistëve të njohur kombëtarë dhe ndërkombëtarë, si dhe nivelin e lartë të mikpritjes dhe argëtimit ka ndërtuar besnikëri ndër vite. Në planet për fundvit “Zone Club” ka përgatitur një plan-program me përzgjedhje të artistëve vendas dhe të huaj. Klientët mund të presin një atmosferë festive, me një miks të muzikës dhe elementeve vizuale që do ta bëjnë çdo natë të paharrueshme. Për Krishtlindje dhe për Vitin e Ri pritet të ketë evente me DJ të famshëm ndërkombëtarë, me surpriza dhe performanca unike.



Muzika elektronike, si prioritet i së ardhmes

“Zone Club” luan një rol të rëndësishëm në edukimin e publikut për muzikën elektronike dhe stilet e saj të shumta. Përmes eventeve të kuruara me kujdes, klubi ka ndihmuar në ndryshimin e perceptimit ndaj këtij zhanri muzikor, duke e bërë atë më të pranueshëm dhe të vlerësuar në kulturën e Kosovës. Ne do të vazhdojmë të kultivojmë muzikën elektronike, duke sjellë në skenë emra të mëdhenj, por edhe duke promovuar zërat e rinj. Ky zhanër muzikor është bërë pjesë e identitetit të klubit dhe vazhdon të tërheqë një



ZONE

MUSIC



DANCE



CLUB



ZONE



danger night club

+383 46 600 444

www.zoneclub.al

Pristina, Kosovo, 10000



POTENCIALI I “TURIZMIT DENTAR” NË KOSOVË

Dhjetëra klinika moderne dentare janë ndërtuar në Kosovë që nga paslufta, ndërsa potenciali i tyre është parë edhe si mundësi e madhe e zhvillimit të vendit. Shembull, Plani Zhvillimor i Prishtinës ka identifikuar si potencial të zhvillimit të Prishtinës klinikat dentare që operojnë brenda kryeqytetit.

Të dhënat tregojnë se “turizmi dentar” në Kosovë është një sektor në zhvillim që ka tërhequr vëmendje të konsiderueshme vitet e fundit. Ky lloj turizmi, i njohur edhe si “turizmi shëndetësor”, përfshin udhëtime për trajtime dentare cilësore dhe me kosto më të ulët se në vendet e tjera. Kosova renditet në mesin e vendeve ku shërbimet dentare janë të cilësisë së lartë, ndërsa çmimet janë më të lira sesa në vendet e EU-së.

Por nga studimet nuk janë vetëm çmimet ato që i shtyjnë qytetarët nga vendet e tjera të vijnë në Kosovë për kujdes dentar.

Qendra Kryesore Universitare e Kosovës ka një departament të stomatologjisë, në të cilin çdo vit diplomohen mjekë stomatologë të fushave të

ndryshme. Qendra e akredituar vlerësohet se përgatit doktorë specialistë të aftë për të kryer punën e tyre në nivelin më të lartë të profesionit.

Përpos cilësisë së doktorëve, brenda vendit janë ndërtuar edhe mekanizma ligjorë të kontrollit të cilësisë së produkteve dhe kontrollit etik të punës së mjekëve.

Të gjitha materialet dentare që përdoren në Kosovë duhet të kalojnë në certifikim nga Agjencia Kosovare për Produkte Medicinale. Kjo agjenci lejon vetëm përdorimin e materialeve që janë në pajtim me standardet e EU-së.


Ngjashëm me medikamentet, kontrolli i cilësisë zhvillohet edhe në produkte, të cilat përdoren për të prodhuar dhe përpunuar pjesët dentare.

Një element shumë i rëndësishëm në Kosovë është procesi i licencimit të mjekëve dhe profesionistëve shëndetësorë. Të gjithë doktorët që punojnë në vend i nënshtrohen procesit të licencimit, ndërsa Oda e Mjekëve të Kosovës kujdeset që në rast të shkarjeve profesionale doktorët të humbin licencat.

Për sigurinë e të gjithë pacientëve, në Kosovë është ndërtuar edhe sistem ligjor, i cili, në rast të gabimeve, u garanton kompensime qytetarëve që janë dëmtuar gjatë procesit.

Të dhënat e tjera tregojnë se, përpos kontrollit të kualitetit, klinikat dentare në Kosovë investojnë në teknologji të reja dhe përdorin materiale të cilësisë së lartë. Lokacioni strategjik i Kosovës në Ballkan e bën të lehtë për vizitorët nga Evropa dhe më gjerë të udhëtojnë për trajtime dentare.

Vizitorët kanë mundësi të shijojnë bukuritë natyrore dhe atraksionet kulturore të Kosovës, si Prizrenin, Rugovën, apo Ulpianën, ndërkohë që kujdesen për shëndetin e tyre oral.



GROUP
Blendi

shpejt,
lirë dhe
kualitet

**SHTYPSHKRONJË | REKLAMA & 3D | MATERIAL ZYRTAR
MATERIAL SHKOLLOR | RAFTA METALIK | KARRIGE PËR ZYRE**

www.blendi-ks.com

[fb](https://www.facebook.com/blendigroup) [ig](https://www.instagram.com/blendigroup) **blendigroup**



KATALOGU
MAKINERIVE



KATALOGU
PROMOCIONAL

Scan Me!



NJË PROGRAM KUSHTUAR MUZIKËS SË FAMILJES STRAUSS



Tradicionalisht, muzika e luajtur gjatë Koncertit të Vitit të Ri është ajo e Strauss, një familje austriake që i dha fisnikërinë e saj valseve të Vjenës në shekullin e 19-të. Më të njohurit janë Johann (1804-1849) dhe tre djemtë e tij: Johann (1825-1899), Josef (1827-1870) dhe Eduard (1835-

1916).

Nëse pjesa më e madhe e veprave të realizuara gjatë Koncertit të Vitit të Ri zgjidhen nga repertori i Shtrausit, gjithsesi ka pak vend për kompozitorë të tjerë, përgjithësisht bashkëkohës dhe më shpesh austriakë. Por, në përgjithësi, programi nuk ndryshon shumë nga viti në vit dhe është larg të qenit i lehtë për t'u luajtur, sipas Albena Danailova, e cila mban pozicionin prestigjioz të koncert-masterit të Phalanxit vjenez.

Muzikantët zgjedhin dirigjentin Deri në vitin 1953, dirigjenti Clemens Krauss drejtoi koncertet e Vitit të Ri. Pas vdekjes së tij, Willi Boskovsky mori drejtimin artistik të evenimentit. Ai mbajti stafetën për 25 vjet, përpara se të zëvendësohej nga Lorin Maazel, deri në vitin 1986. Muzikantët e orkestrës vendosën

më pas të zgjidhnin një dirigjent të ndryshëm çdo vit. Një nominim që është i barabartë për një dirigjent, me një nga njohjet më të mëdha në botën klasike.

Pas më shumë se 80 shfaqjeve, me 19 dirigjentë të ndryshëm, të gjithë meshkuj, a ka mundësi që Filarmonia e Vjenës së shpejti të zgjedhë një grua për të mbajtur stafetën në këtë eveniment prestigjioz? Për këtë pyetje të bërë, rreth një vit më parë, nga një gazetar, Daniel Froschauer, drejtor i falangës vjeneze, pati këtë përgjigje lakonike: "Do të kemi një lider kur të jetë koha e duhur", i cili nuk ka munguar të reagojë.

Orkestra Filarmonike e Vjenës, e njohur si konservatore, për një kohë të gjatë, përbëhej vetëm nga burrat. Tani janë 24 gra, nga rreth 145 anëtarë të këtij grupi.

PRISHTINA

RENT A CAR

Shijo Pushimet Tuaja

Me veturat e modeleve të fundit!



ANDROID APP ON
Google play



Download on the
App Store

Skeno > Shkarko > Rezervo > Zbritje përfito



+38344240383



rentacar-prishtina.com



KOSOVA, SHTETI ME PASURI TË MËDHA NËNTOKËSORE

Ari, argjendi, plumbi, zinku e qymyri janë vetëm disa prej pasurive nëntokësore, të cilat i ka Kosova. Me përjashtim të linjtit, prej të cilit është prodhuar rrymë tash e 25 vjet, pasuritë e tjera nuk kanë arritur të japin kontribut në zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Me gjithë faktin se gjatë viteve të kaluara Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale ka lëshuar shumë licenca për hulumtim të nëntokës, deri më tani nuk kemi ndonjë ndërmarrje të madhe të krijuar apo rritje të eksporteve.

Cilat janë pasuritë nëntokësore të Kosovës?

Bazuar në të dhënat e Komisionit të Pavarur për Miniera e Minerale, metalet e çmuara (ari dhe platin) e pasurojnë nëntokën e Kosovës dhe ato janë dalluar pas mostrimit gjeokimik nëpër përroska e lumenj dhe



si metale shoqëruese në xeherore të tjera (kromite dhe metale bazë, si plumbi dhe zinku). Në Strategjinë Minerare të Kosovës (2012-2025) janë paraqitur të dhëna për përmbajtjen e arit në secilin ton të eksploatuar. Miniera e Artanës (ish-Novobërda) është më e pasura sa i përket arit. Vlerësohet se resurset e arit në minierën e Artanës janë rreth 2,700 kg.

“ Shembull, në Stantërg vlerësohet se përmbajtja e arit në një tone minerare është vetëm 0.6 gram. Kurse, Miniera e Artanës është gati trefish më e pasur me ari, pasi në çdo ton mund të gjenden deri në 1.6 ari. Pas Artanës, është Miniera e Kizhnicës më e pasura, në të cilën mund të gjenden 1.1 gramë ari në çdo ton të eksploatuar, e pasuar nga Miniera e Cërnacit, me 1 gram ari në një ton.

“Sipas vendburimeve, vlerësohen këto përmbajtje të arit: Stantërg: 0.6 g/t, Bellobërdë: 0.7 g/t, Cërnac: 1.0 g/t, Hajvali: 0.5 g/t, Kizhnicë: 1.1 g/t, Badovc: 0.25 g/t, Artanë: 1.6 g/t, Crepulë: 0.13 g/t”, thuhet tutje në Strategjinë Minerare për periudhën 2012-2025.

“Trepça”, tuneli në të cilin nuk po shihet drita në fund

Prodhimi i rregullt në “Trepçë” ka nisur në vitin 1930 dhe për një kohë shumë të shkurtër “Trepça” ishte shtylla kryesore industriale e ekonomisë së Kosovës.

Miniera “Trepça” ka një infrastrukturë moderne, sipas modelit bashkëkohor të minierave nëntokësore, i ka tri puse servili dhe të ajrosjes, është e zhvilluar në 2 horizonte, kurse





ndërmjet tri horizonteve të fundit janë zhvilluar rampat që mundësojnë aplikimin e mekanizimit bashkëkohor në përgatitje dhe në shfrytëzim të xehes.

“Miniera, me infrastrukturën e vet si dhe me metodat bashkëkohore të mbushjes, ka kapacitetin e shfrytëzimit të xehes prej 500.000 deri në 650.000 tonë xehe në vit. Arritja e kapacitetit të plotë të minierës është e kushtëzuar me numrin e duhur të punëtorëve, si dhe me investimet e parapara për freskimin e mekanizimit dhe eliminimin e “fytëve të ngushta”.

Zona metalogjenike e minierës

“Trepça”, përveç vendburimit kryesor, karakterizohet edhe me një numër të vendburimeve në rrethinë, të cilat kanë shkallë të ndryshme të hulumtimeve të realizuara gjeologjike.

Pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, ndërmarrja “Trepça” kaloi nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Pas shumë përpjekjeve, në nëntor të vitit 2016, Kuvendi i Kosovës e shpëtoi “Trepçën” nga likuidimi me nxjerrjen e Ligjit për “Trepçën”, me ç’ rast e transformoi atë në shoqëri aksionare. 80% të aksioneve të kësaj korporate janë pronë e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe 20% të aksioneve në pronësi të punëtorëve të “Trepçës”.

Trepça nuk ka arritur të kontribuojë në zhvillimin ekonomik të Kosovës, pasi është obliguar të marrë para nga buxheti i Republikës së Kosovës për të mbuluar kostot e operimit dhe të pagave. Bazuar në Raportin e Performancës së Ndërmarrjeve

Publike, për vitin 2022, rezulton që “Trepça” i kishte mbyllur me humbje vitet 2021 dhe 2022. Disa prej sfidave, me të cilat përballet “Trepça” dhe që janë listuar në këtë raport, janë: moshja e shtyrë e fuqisë punëtore në miniera dhe në flotacionet e ndërmarrjes, pajisjet e vjetërsuara dhe jo kompaktibile me metodat bashkëkohore për eksploatim dhe pasurim të mineraleve, si dhe rreziku nga jolikuiditeti i mjaftueshëm.

Mundësitë e investimeve

Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës për periudhën 2012-2025 përcakton politikat dhe masat për zhvillimin e sektorit mineral, në dobi të zhvillimit ekonomik dhe të mirëqenies sociale.

Njëra nga pikat në programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025 është edhe përmirësimi i performancës së sektorit mineral. Në program thuhet se do të angazhohemi për shfrytëzimin optimal të burimeve minerare. Do të avancojmë kornizën ligjore dhe do të analizojmë gjendjen e “Trepçës” dhe minierave të tjera në Kosovë, me qëllim të ngritjes së performancës



së tyre, dhe do të identifikojmë potencialin e rritjes së kapaciteteve prodhuese.

Ndërsa, në uebfaqen e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale janë paraqitur disa udhëzime për investitorët potencialë, duke treguar vendburimet e mundshme për hulumtim, si dhe licencat e nevojshme për të kryer hulumtime apo eksploatim të mineraleve.

Qeveria i ka shpallur njëmbëdhjetë (11) zona si “Zona me interes të veçantë” për hulumtime të mineraleve të ndryshme. Zona me interes të veçantë për hulumtimin e lëndës minerale të plumbit dhe të zinkut janë: Vllahi - Zjaqë, Gumnishtë, Karaqë, Zhegovcë, Bresalcë dhe Bushincë - Bolec. Pastaj lënda minerale e nikelit dhe kromit është në lokacionin në Baks, ndërsa minerale të rralla si kuarcite janë në Debëllde.

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPM) lëshon këto licenca/leje pas përmbushjes së kushteve, në bazë të Ligjit për Miniera dhe Minerale, të cilat mundësojnë hulumtimin për minerale dhe për shfrytëzim të tyre.





Teknologji nga **A** deri në **Z**

Një histori sukcesi që filloi nga Prishtina dhe sot frymëzon një rajon të tërë.

Në zemër të Ballkanit, në Republikën e Kosovës, AZTECH u themelua me një vizion të thjeshtë por të fuqishëm: të sjellë risitë më të fundit teknologjike pranë çdo shtëpie dhe biznesi. Duke filluar me një dyqan të vogël në Prishtinë, sot AZTECH është një ndër liderët në tregun e elektronikës, me 10 dyqane në 8 qytete dhe një portofol produktesh nga markat më të njohura botërore.



AZTECH – Më shumë se një dyqan

AZTECH nuk është vetëm një destinacion për blerje, por një partner besnik në udhëtimin tuaj teknologjik. Me ekspertë të specializuar dhe shërbim të shkëlqyer ndaj klientit, ne jemi këtu për t'ju ndihmuar të zgjidhni dhe të përfitoni maksimumin nga produktet më të fundit.

Vizitoni AZTECHONLINE.COM

Për ata që preferojnë të blejnë nga komoditeti i shtëpisë së tyre, AZTECH ka një platformë të avancuar online. Në aztechonline.com, ju mund të eksploroni një gamë të gjerë produktesh, të përfitoni nga ofertat ekskluzive dhe të bëni blerje të sigurta me disa klikime. Platforma jonë është e lehtë për t'u përdorur dhe ofron dërgesa të shpejta dhe të sigurta në të gjithë teritorin e Republikës së Kosovës.

Vizitoni dyqanet tona në Prishtinë, Fushë Kosovë, Prizren, Podujevë, Ferizaj, Gjilan, Drenas, dhe Gjakovë, ose shikoni ofertat tona më të fundit në www.aztechonline.com.

Risia teknologjike, në dorën tuaj.



www.aztechonline.com

5 PRODUKTET MË INOVATIVE



PHILIPS

Shijoni përvojën kinematike me Philips OLED, ku ngjyrat janë më të gjalla dhe e zeza më e thellë. Me teknologjinë unike Ambilight, dritat rreth televizorit ndjekin veprimin në ekran, duke krijuar një përvojë të plotë zhytjeje. Ekran i OLED sjell cilësi të pabesueshme të imazhit, ndërsa Ambilight ju bën të ndiheni si pjesë e çdo scene.

SAMSUNG

Televizorët Samsung me ekran QLED ofrojnë një eksperiencë të jashtëzakonshme pamore. Përveq cilësisë së imazhit të jashtëzakonshëm të QLED, ai integron teknologji të mençura për të përmirësuar përvojën e shikimit, ky televizor sjell kinematografi në mënyrë të paimagjinueshme.



Apple MacBook Pro

Nëse jeni duke shikuar për një laptop të fuqishëm iu rekomandojmë MacBook Pro me çip M3 i cili ofron shpejtësi dhe aftësi të pakompromista për të kryer detyrat më kritike me një lehtësi të jashtëzakonshme, kjo bën që MacBook Pro të jetë një zgjidhje e shkëlqyer përdoruesit të cilët kërkojnë një kombinim të elegancës dhe efikasitetit.

SAMSUNG

Eksploroni teknologjinë e avancuar me Samsung Galaxy S24 Ultra. Me kamerën e tij 200 MP, kapni çdo detaj me qartësi të pabesueshme. Ekran i Dynamic AMOLED 2X 6.8" ofron ngjyra të gjalla dhe shpejtësi përfekte për çdo përdorim. Me procesorin e fuqishëm Snapdragon 8 Gen 3 dhe baterinë 5000 mAh, përjetoni performancë të pakompromis gjatë gjithë ditës. Galaxy S24 Ultra është krijuar për ata që kërkojnë më të mirën në teknologji dhe dizajn.



SAMSUNG

Opsioni AddWash në rrobalarëset Samsung sjellë një përparim të ndjeshëm në mënyrë se si i lani rrobat. Me funksionin AddWash, ju keni mundësinë për të shtuar rroba edhe pasi që procesi i larjes ka filluar. Përveq kësaj rrobalarësja vjen me teknologji të avancuar të pastrimit që siguron larje të efektshme dhe të kujdeshme për rrobat tuaja.

BENEFICIONET E MAKINAVE ELEKTRIKE

Futja në treg e makinave elektrike ka sjellë një frymë të re në tregun e makinave.

Blerësit në vazhdimësi janë duke kërkuar më shumë makina elektrike dhe beneficionet e tyre po vazhdojnë të proklamohen si shpëtim i ambientit në të cilin jetojmë.

Edhe nëse për disa u konsiderua një modë teknologjike që nuk do të zgjasë, të dhënat aktuale tregojnë pikërisht të kundërtën. Makinat elektrike kanë ardhur për të qëndruar. Përparësitë e makinave elektrike ndaj makinave tradicionale, me benzinë, janë të shumta dhe kjo është arsyeja pse çdo vit ato fitojnë gjithnjë e më shumë besimin e shoferëve modernë. Në fakt, shumë vende kanë synime për të ndaluar shitjet e automjeteve me benzinë dhe naftë në të ardhmen.

PO CILAT JANË BENEFICIONET KRYESORE TË MAKINAVE ELEKTRIKE:

Kosto më të ulëta të karburantit

Përfitimi më i dukshëm i blerjes së një makine elektrike është kursimi i koston. Marrja e një makine elektrike mund të jetë më e shtrenjtë se një model i ngjashëm me motor, benzinë ose naftë, por në planin afatgjatë dikush kursen më shumë, pasi kostoja e karburantit është shumë më e ulët. Si rezultat, blerja e një makine elektrike duhet të trajtohet si një investim, pasi, pavarësisht shumës fillestare, është një zgjidhje me kosto efektive. Për më tepër, një makinë elektrike na shpëton nga nevoja për të furnizuar me karburant në një pikë karburanti, pasi mund ta ngarkojmë atë në shtëpi.

Kosto më të ulëta të mirëmbajtjes

Si rezultat i avantazhit të parë kemi faktin se, përveç kostove të ulëta të karburantit, makinat elektrike, gjithashtu, kanë kosto më të ulëta të mirëmbajtjes. Ato nuk kërkojnë ndryshim të vajrave, filtrave, prizave dhe pjesëve të ndryshme të këmbimit, të lidhura me një makinë konvencionale dhe të cilat rrisin ndjeshëm kostot e mirëmbajtjes së





një makine. Me kalimin e kohës, kjo kosto e reduktuar mund të çojë në kursime të konsiderueshme.

Miqësore me mjedisin

Nuk ka asnjë pyetje për këtë. Makinat elektrike janë mënyra më e mirë për të zvogëluar gjurmët tuaja mjedisore. Modelet tradicionale të makinave krijojnë shumë probleme mjedisore, për shkak të ndotësve të dëmshëm që lëshojnë. Një makinë elektrike është alternativa ekologjike pasi lëshon zero ndotës. Me ekspertët që i bien ziles së alarmit çdo ditë rreth problemeve mjedisore, me të cilat përballet planeti ynë, është mirë që të gjithë ne po fillojmë të fitojmë vetëdije ekologjike. Marrja e një makine elektrike mund të ndihmojë në këtë aspekt.

Drejtimi i rehatshëm

Automjetet elektrike ofrojnë një përvojë më të rehatshme dhe të relaksuar drejtimi. Ato në përgjithësi kanë një qendër më të ulët të gravitetit, e cila ofron trajtim, rehati dhe përgjigje më të mirë. Motori elektrik siguron nxitim dhe ngadalësim të qetë për një udhëtim të qetë. E gjithë kjo i bën automjetet elektrike të këndshme për t'u drejtuar.

Privilegjet e veçanta

Në qendrat e mëdha urbane, drejtuesit e makinave elektrike nuk shqetësohen për të gjetur një vend parkimi, pasi ofrohet qasje falas ose me kosto të ulët në shumë parkingje. Për më tepër, shoferi i një makine elektrike gëzon uljen e taksës së rrugës dhe lëvizjen e lirë në ring. Së fundi, përmes programit "në lëvizim në mënyrë elektrike" sigurohet një subvencion për blerjen ose marrjen me qira afatgjatë të një automjeti elektrik, ndërsa një subvencion mund të jepet edhe për instalimin në banesën kryesore të një

karikuesi të zgjuar shtëpiak.

Paketat e specializuara të sigurimit

Makina ndryshon dhe sigurimi përshtatet me të dhënat e reja. Makinat elektrike punojnë ndryshe nga ato konvencionale dhe kjo është arsyeja pse paketat tradicionale të sigurimit nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar plotësisht pronarin dhe automjetin. Përmes paketave të veçanta të sigurimit, shoferi i një makine elektrike tani është i sigurt se do të gjejë sigurimin që e mbulon, në mënyrë që ai të mund të ngasë i sigurt dhe me besim!

Lehtësirat në mbushje elektrike

Në nismën për të zëvendësuar makinat me karburante me makina elektrike ishte shpërfaqur sfida e mbushjes së tyre me energji elektrike. Paisjet e rimbushjes ishin të rralla dhe shoferët duhej të kishin një plan të detajuar për t'u rimbushur gjatë udhëtimeve të gjata.

Mirëpo, këto probleme tashmë kanë nisur të ndryshojnë. Në Kosovë dhe në Shqipëri tashmë janë vendosur dhjetëra pajisje të mbushjes së shpejtë në pika të karburanteve dhe trendet tregojnë që bizneset planifikojnë të rrisin kapacitetet edhe më shumë.

Si rezultat, një pjesë e autostradave tashmë kanë qendra të mbushjes, ndërsa në dalje të qyteteve të mëdha pompat e derivateve e ofrojnë shërbimin.



thirr.com

INTERNETI MË I MIRË 5G PËR KOSOVË & EUROPE
AKTIVIZOJE eSIM ONLINE OSE TEK PIKA NË AEROPORT (TEK DALJA)

199€

QENDRA EKSKLUZIVE E PUSHIMIT NË RRETHIN E FERIZAJT

E ndërtuar nga familja Rysha, qendra “Natural Pool & Spa” është njëra nga qendrat më të mëdha në Kosovë për pushime.

E hapur në vitin 2023, qendra është shndërruar në adresë për pushuesit, të cilët, krahas ushqimit të shijshëm, mund të shijojnë edhe shërbimet e pishinave dhe SPA-së që ofrohet në kompleks. Aty janë gërshtuar shërbimet e veçanta, duke filluar nga saunat me kripë të himalajeve, banjët turke, saunat tradicionale, e deri te masazhet tajlandeze. Qendra ofron pishina të hapura dhe të mbyllura për not, për të rriturit dhe fëmijët, ndërsa mysafirët shërbehen nga një staf profesional i certifikuar.

Në restorantet elitare të qendrës pushuesit mund të shijojnë ushqimet e përgatitura nga kuzhinierët e kompleksit, ndërsa hapësira ofron mundësi të hatashme për aranzhmane të tjera, si dasmat apo organizimet e tjera familjare.

Pushuesit në vazhdimësi kanë dhënë mesazhe lavdëruese për qendrën dhe e kanë renditur lart qendrën në rrjetet sociale.

Para se të niseni, ju mund të kontrolloni çmimet e shërbimeve, të cilat janë të detajuara në faqen e qendrës. Qendra ofron mundësi të rezervimit të hapsirave dhe menyve të veçanta.

Në menynë e ushqimit ju mund të gjurmoni nga ushqimet tradicionale deri tek ushqimet e detit, me çmime mesatare për tregun e Kosovës.

Qendra është e ndarë në disa zona dhe ofron shërbime ekskluzive.

“Natural Pool & Spa” ofron tri pishina të mëdha, përveç dy restoranteve.

- Pishinë të brendshme, me një sipërfaqe prej 550 m²
- Pishinë për fëmijë, me një sipërfaqe prej 111m²
- Pishinë të jashtme, me një sipërfaqe prej 311m²

Sipërfaqja premium e pishinës, me një sipërfaqe prej 300m²

Zona Premium është një shenjtërore ekskluzive, që ofron qetësi të lartë dhe pajisje luksoze: 1 pishinë për fëmijë, 1 pishinë të brendshme për të rritur.


- 1 pishinë të mbrendshme për të rritur, me qasje të drejtpërdrejtë në pishinën e jashtme (në dispozicion në çdo sezon);
- 3 sauna finlandeze në natyrë;
- 5 xhakuzi në natyrë;
- 3 xhakuzi me ujë të ftohtë në natyrë;
- 3 xhakuzi të brendshëm;
- 3 sauna finlandeze të brendshme;
- 1 saunë të brendshme me rreze infra të kuqe;
- 1 saunë bimore të brendshme;
- 1 hamam (banjë turke).



Shtrat për rrezitje - solarium




Sauna me kripë kristale himalaje është një përvojë unike dhe relaksuese.



Bio Sauna (HERBAL)



NATURAL
POOL&SPA



@NATURAL POOL&SPA



WWW.NATURAL-KS.COM



+38348473473



SOJEVË , FERIZAJ



LULISHTJA LABI

Jepni jetë kopshtit tuaj!



+ 383 49 777 406



www.lulishtjalabi.com



Magjistranja Prishtinë-Ferizaj

QENDRAT KRYESORE TË SKIJIMIT NË BALLKAN

Zona e Ballkanit njihet për atraksione turistike dhe zona me male të larta, të cilat shfrytëzohen për ski dhe turizëm malor. Përpos ecjeve të gjata gjatë verës, Ballkani është i populluar me dhjetëra qendra të skijimit, në të cilat vizitorët mund të shijojnë skitë dhe turizmin elitare të dimrit.

Industria e qendrave të skijimit u zhvillua në fillim të viteve të 80-ta, si parapërgaditje për Lojërat Olimpike Dimërore, të cilat u mbajtën në Bosnje në vitin 1984. Lojërat Olimpike Dimërore të Sarajevës u mbajtën në vitin 1984 në Sarajevë, atëherë pjesë e Jugosllavisë, dhe ishin Lojërat XIV Olimpikë Dimërore. Kjo ishte hera e parë që një vend socialist i organizoi Lojërat Olimpikë Dimërore dhe një nga momentet më të rëndësishme sportive në historinë e rajonit. Pjesa më e madhe e garave u mbajtën në zonën e Sarajevës dhe të maleve përreth, si Bjelašnica, Jahorina, dhe Trebević. Maskota zyrtare: Një ujk i quajtur Vučko, i cili simbolizonte mikpritjen dhe shpirtin e lojërave. Sot një pjesë e këtyre rezorteve të skijimit janë të boshatisura për shkak të luftës së Bosnjes. Por në zonat e tjera të Ballkanit qendrat turistike i kanë mbijetuar modernizimit dhe janë shndërruar në zona atraktive.



BANSKO, BULLGARI

Qendra e skijimit në Bansko është një nga qendrat më të njohura të skijimit në Ballkan dhe ofron infrastrukturë moderne, duke përfshirë teleferikë dhe hotele të rehatshme. Kjo qendër ka një pistë prej 75 km për ski, të përshtatura për nivele të ndryshme. Gjatë qëndrimit në këtë qendër pushuesit mund të relaksohen në SPA, banja termale dhe aktivitete kulturore në qytetin historik.

QENDRA E BREZOVICËS, KOSOVË

Brezovica është qendra më e madhe për ski në Kosovë. E vendosur në Malet e Sharrit, kjo qendër ofron peizazh të mrekullueshëm dhe kushte të mira për ski. Në zonë ka të vendosur teleferikë dhe disa hotele, të cilat akomodojnë qindra pushues. Qendra e vjetër e skijimit ka kapacitete të akomodojë qindra turistë, ndërsa hotelet e reja, të ndërtuara pas luftës, vlerësohen për një ambient elitare, me SPA dhe pishina të brendshme.





MAVROVË, MAQEDONIA E VERIUT

Qendra e skijimit në Mavrovë është e vendosur në Parkun Kombëtar Mavrova dhe ofron peizazhe natyrore të mrekullueshme. Pista e skijimit është e gjatë rreth 25 km dhe vlerësohet si pistë e lehtë për t'u skijuar nga skiatorë fillestarë dhe skiatorë të mesëm. Pushuesit e kësaj zone mund të eksplorojnë liqenin e Mavrovës dhe ushqime tradicionale të zonës.

BOROVETES, BULLGARI

Borovetes është njëra nga qendrat më të vjetra të skijimit në Bullgari. Ajo ka një pistë të gjatë prej 58 kilometrash, të ndarë në zona, sipas rrezikshmërisë. Në zonën e kësaj qendre ka të vendosura hotele, të cilat ofrojnë kushte të mira për SPA dhe jetë të natës.



POPOVA SHAPKA, MAQEDONI E VERIUT

Qendra e Popova Shapkës është e vendosur gjithashtu në Malet e Sharrit dhe është e njohur për terrenet ideale për ski jashtë pistave. Gjatësia e pistave është rreth 20 kilometra për të gjitha nivelet. Kjo qendër njihet për terrenin për ski "off-piste" dhe panorama spektakolare.

GJERAVICA, KOSOVË

Gjeravica është maja më e lartë në Kosovë dhe ndodhet në Alpet Shqiptare (Bjeshkët e Nemuna). Me një lartësi prej 2,656 metrash mbi nivelin e detit, ajo është një destinacion shumë i preferuar për adhuruesit e natyrës, ngjitësit e maleve dhe aventurierët. Zona nuk ka turizëm industrial të skive, por është e njohur për skiatorët e egër, të cilët synojnë të zhvillojnë ski në terren të paeksploruar më parë.

Shpatet e mbuluara me borë gjatë dimrit ofrojnë mundësi të shkëlqyera për eksperiencë unike, megjithatë kërkohet përgatitje e mirë, pajisje të duhura dhe kujdes, për shkak të terrenit të ashpër dhe të paparashikueshëm. Nëse po mendoni të skioni në Gjeravicë, është mirë të kontaktoni guida lokale, ose klube alpinistike që mund të ndihmojnë me planifikimin dhe sigurinë e ekspeditës. A keni menduar për ndonjë periudhë të caktuar për ta vizituar?





ZONAT ATRAKTIVE PËR T’U VIZITUAR GJATË DIMRIT NË SHQIPËRI

Shqipëria është atraksion turistik edhe gjatë dimrit. Në hotelet buzë detit në vazhdimësi janë promovuar oferta për pushues, adhurues të ushqimeve dhe të qendrave të SPA, ndërsa në zonat malore promovohet turizmi malor dhe vizitat në ilixhet e zonës.

Pa dyshim listës për t’u vizituar i prijnë alpet shqiptare, me zonat e bukura dhe të thella të Thethit dhe të Valbonës.



THETHI DHE VALBONA

Alpet shqiptare janë të magjishme në dimër. Thethi dhe Valbona ofrojnë pamje spektakolare, me male të mbuluara me borë dhe fshatra tradicionale. Në zonë nuk ka shtigje të skijimit, mirëpo ecja në natyrë, eksplorimi i ujëvarave të ngrira (si Ujëvara e Grunasit) dhe përjetimi i mikpritjes tradicionale shqiptare janë të rekomandueshme për turistët.

KORÇA DHE DARDHA

Qyteti i Korçës është i njohur si “Parisi i Vogël”. Gjatë dimrit, qyteti njihet veçanërisht për stolisjen me drita festive. Adhuruesit e muzikës dhe të ushqimit në këtë qytet gjejnë muzikën korçare të shoqëruar me ushqimet tradicionale të zonës. Në Korçë vizitorët rekomandohen të vizitojnë edhe fshatin Dardha. Ky është një fshat malor pranë Korçës, ideal për ski dhe pushime relaksuese.



VOSKOPOJA

Në turin e vizitave për në Shqipëri, vizitorët rekomandohen të vizitojnë edhe fshatin Voskopojë. Ky fshat ka një atmosferë të qetë dhe është i njohur për kishat e tij të vjetra dhe peizazhet e mrekullueshme.



BOGE DHE VERMOSHI

Zona e Kelmendit është një thesar i fshehur gjatë dimrit, duke ofruar pamje magjike të bjeshkëve dhe qetësi absolute. Në vizitat në Boge dhe Vermosh turistët mund të shijojnë eksplorimin e natyrës dhe përvojat autentike në shtëpi tradicionale malore.

POGRADECI DHE LIQENI I POGRADECIT

Midis Shqipërisë dhe Maqedonisë shtrihet Liqeni i Ohrit dhe Pogradecit. Ky liqe është në mesin e liqeneve më të mëdha në Ballkan dhe njihet me këta dy emra. Gjatë muajve të dimrit, liqeni ka një pamje të bukur dhe romantike, ndërsa vizitorët e Pogradecit mund të shijojnë, përpos kësaj pamje, edhe vizitat në Drilon dhe shijimin e peshkut tradicional koran.



ELBASANI DHE LLIKHAT E ELBASANIT

Në qytetin e Elbasanit burojnë llixhat termale të kësaj zone. Vizitorët mund të pushojnë në hotelet e zonës të lidhura me llixhat shëruese. Gjatë kohës së relaksimit, për vizitorët Elbasani ofron një kulturë të pasur dhe histori interesante.

GJIROKASTRA DHE BERATI

Berati dhe Gjirokastra janë dy qytete muze, të cilat mund të vizitohen në çdo stinë të vitit. Shtëpitë e vjetra tradicionale, kalatë e zonës dhe ushqimet tradicionale, i mirëpresin vizitorët gjatë gjithë kohës.

Për turistët në zonë janë ndërtuar hotele dhe bujtina tradicionale



LLOGARAJA

Për vizitorët që preferojnë një dimër më të butë, Llogaraja ofrojnë një pamje fantastike dhe qetësi. Gjatë muajve të dimrit, në Llogarajë vizitorët mund të bëjnë eksplorimin e Parkut Kombëtar të Llogarasë dhe vizita në fshatra bregdetare, si Dhërmiu dhe Himara.





KOMPLEKSI EKSKLUZIV NË ZONËN E PASTËR TË

Kompania gjigante e ndërtimeve në Durrës dhe Kavajë, “Bonita Konstruksion”, ka nisur shitjen e apartamenteve dhe hapësirave në kompleksin e ri të ndërtimeve, në fshatin turistik të Qerretit, në Kavajë.

Kompleksi, me rreth 500 apartamente, ka filluar të ndërtohet nga muaji qershor i vitit 2024 dhe është i vendosur në zonën e fshatit turistik të Qerretit.

Ky fshat është i njohur për zonën e pastër dhe të ndërtuar me planifikim të detajuar urban. Qerreti është pjesa më e bukur e zonës së Kavajës dhe njëra nga zonat e ndërtuara me perfeksion të planifikimit urban.

Zona e Qerretit njihet për plazhin e gjerë, skaj të cilit janë të renditura pishat e gjata që krijojnë bregun e gjerë të gjelbër të zonës. Investimet nga qeverisja lokale kanë krijuar mundësinë që Qerreti të ketë një park të gjerë skaj plazhit dhe një shëtitore të bukur, e cila në disa zona gjarpëron brenda detit.

Kompleksi i ri “Bonita” është i vendosur në zonën mbi pishat e Qerretit dhe ndërtimi garanton pamje nga deti për pjesën më të madhe të apartamenteve.

Arkitektët kanë planifikuar ndërtimin e objektit për të mundësuar që nga tarracat e tyre apartamentet të kenë pamje nga deti. Ky stil ndërtimi krijon mundësinë që vizitorët të shijojnë gjatë gjithë kohës pamjen që nga lindja deri te perëndimi i diellit.

I ndërtuar për të ruajtur ambientin e zonës, kompleksi është projektuar të ketë qasje në plazhin e zonës, me një ecje të shkurtër gjatë rrugës së shtrirë në pishat e larta, të cilat në Qerret janë ruajtur me kujdes në tërësinë e tyre.



Kompleksi do të ketë parking nëntokësor dhe infrastrukturë përcjellëse, si hotelet, dyqanet dhe restorantet brenda kompleksit.

Kompania ka paraparë edhe mundësi atraktive për klientët që vendosin të investojnë në këtë kompleks. Investitorët potencialë duhet të dinë për mundësitë e financimit me këste, mundësitë e qiradhënies së banesave të tyre, kapacitetet shërbyese të kompleksit, dhe mundësitë për të adoptuar hapësirat sipas kërkesave specifike.

Mundësitë për pagesë me këste

Kompania ka garantuar një skemë të financimit, përmes së cilës blerësit nuk janë të obliguar të paguajnë tërë



I PUSHIMIT QERRETIT

shumën në ditën e blerjes së apartamentit. Në negociatat me kompaninë, klientët mund të paguajnë për blerjen e apartamentit duke filluar nga 40% e vlerës së investimit. Në negociata me zyrën e shitjes për klientët që vendosin të kryejnë pagesën e plotë të apartamenteve në avancë.

Mundësia e qiradhënies së banesës së blerë

Në kompleksin "Bonita" investitori e ka paraparë ndërtimin e një hoteli të brendit "Bonita". Blerësit e banesave do të kenë mundësi që në kohën kur nuk i shfrytëzojnë banesat t'i japin me qira për hotelin "Bonita" dhe klientët e tjerë. Ky sistem u garanton investorëve kthim të investimit nëpërmjet qiradhënies, e cila në vitet e fundit në zonën e Qerretit është rritur shumë edhe në kërkesë, edhe në çmim.

Mundësia e adaptimit të hapësirave

Objektet në ndërtim në kompleksin "Bonita" kanë mundësi të adaptimit të hapësirave për nevojat specifike të klientëve. Brenda mureve, kompania mund të krijojë ndërhyrje për të përshtatur kërkesat e klientëve, për të rritur apo zvogëluar hapësirat e dhomave. Bashkë me këto klientët, mund të vendosin të përdorin materiale specifike në renovimin e hapësirave të brendshme të objektit.

Kapacitetet shërbyese të kompleksit

Kompleksi i ri "Bonita" ka paraparë ndërtimin e kapaciteteve shërbyese për banorët e kompleksit.

Një hotel i brendit "Bonita" do të jetë i ndërtuar brenda kompleksit, bashkë me kompleksin e restoranteve dhe bareve të hotelit. Kompleksi do të ketë edhe qasje në plazh,

ndërsa për banorët dhe klientët arkitektët kanë planifikuar ndërtimin e një "Aqua parku", me disa pishina dhe pajisjet përcjellëse, si topoganët dhe lodrat ujore, për të rriturit dhe për fëmijët. Brenda kompleksit do të ketë pishina të mbyllura SPA dhe parkingje nëntokësore.

Informacionet për blerësit

"Bonita Konstruksion" ka prezantuar tashmë projektin para klientëve dhe të interesuarve.

Zyra e shitjeve ka lansuar edhe linjën e drejtpërdrejtë të kontaktit në telefon dhe në WhatsApp, në numrin e telefonit +355 69 238 6456 (direkt ose WhatsApp). Klientëve u rekomandohet vizitë në vendpunishten ku po ndërtohet objekti dhe vizitë në projektet e tjera të ndërtuara nga "Bonita Konstruksion", në të cilat janë shitur qindra apartamente.



Çfarë dimë për zonën e Qerretit?

Fshati Qerret është një zonë e populluar nga banorë lokalë, të cilët në brendësi të fshatit zhvillojnë ekonomitë e tyre familjare. Në zonën bregdetare, që nga rënia e komunizmit e deri më tani, janë ndërtuar disa hotele dhe komplekse banimi, kryesisht luksoze.

Zona është e njohur për ndërtim të planifikuar urban, i cili e bën të dallohet nga zonat e tjera ndërtimore. Fshati është i vendosur skaj autostradës Durrës-Vlorë dhe ka infrastrukturë të mirë të rrugëve, ndriçimit publik dhe infrastrukturës komunale, si uji dhe qasja në shërbime kablore të internetit.

Zona njihet si zonë e sigurt dhe e mbikëqyrtur 24 orë nga kamerat e sigurisë dhe kompani private të sigurimit.

Bukuritë e bregdetit të Qerretit janë vërtet mahnitëse! Ky fshat bregdetar, i vendosur midis Durrësit dhe Kavajës në Shqipëri, ka fituar popullaritet falë natyrës së tij të pastër dhe qetësisë që ofron për vizitorët. Disa nga veçoritë kryesore të Qerretit përfshijnë plazhin e pastër dhe të gjerë. Uji i detit është i pastër dhe i qetë, ideal për familjet dhe për ata që kërkojnë relaksim. Zona përreth plazhit është e pasur me pisha dhe gjelbërim, duke krijuar një atmosferë të freskët dhe relaksuese. Pyjet me pisha ofrojnë një kombinim perfekt midis bregdetit dhe natyrës.

Nga Qerreti mund të vizitoni lehtësisht qytetin e Kavajës, Durrësin, apo edhe vendet historike, si Amfiteatri i Durrësit dhe Kalaja e Krujës. Afër zonës ndodhen edhe Parku Nacional i Divjakës dhe zonat e tjera historike.



USHQIMI QË PROMOVOHET NGA SHQIPTARËT

Flia është një nga gatimet tradicionale shqiptare, e njohur veçanërisht në Kosovë, në Mal të Zi dhe në Maqedoninë e Veriut. Flia është një ushqim me bazë brumi dhe yndyrë natyrale, e cila gatuhet në një procedurë të gjatë të pjekjes. Varësisht nga forma e përgatitjes, flia përmban dy komponentë kryesorë: qullin e miellit dhe yndyrën (mazën) e qumështit.

Shija e veçantë e gatimit të flisë buron nga mënyra e pjekjes së saj. Në zonat tradicionale flia gatuhet duke u pjekur me saç, i cili ngrohet në zjarr të druve. Kombinimi i nxehtësisë dhe aromës së tymit të saçit i japin ushqimit një aromë të mirë dhe shije të veçantë.

Në zonat tradicionale vizitorët mund të konsumojnë flinë e saçit, ndërsa në zonat urbane furrat dhe kompanitë private e kanë komercializuar prodhimin duke përdorur saç elektrik apo furra për pjekje.

PËRBËRËSIT KRYESORË TË FLISË:

- Miell gruri
- Ujë
- Kripë
- Mazë ose ajkë për lyerjen midis shtresave

SI PËRGATITET FLIA:

Përzierja e brumit: Mielli, uji dhe kripa përzihen derisa të krijohet një masë e hollë, e ngjashme me një pastë për petulla.

PJEKJA NË SHITRESA: Brumi derdhet në një

tepsi, shtresë pas shtrese. Pas çdo shtrese, ajo piqet në sobë ose nën saç, derisa të marrë një ngjyrë të artë.

LYERA NDËRMJET SHITRESAVE: Pas çdo pjekjeje, shtresat lyhen me gjalpë të shkrirë ose vaj për të dhënë një shije më të mirë dhe për të mos i lejuar që të ngjiten.

PJEKJA FINALE: Pasi të jenë shtuar të gjitha shtresat dhe tepsia të jetë plot, flia lihet të piqet derisa të marrë një ngjyrë të artë në sipërfaqe.

DESIGN

REKLAMA 3D

Be Only Premium

DIGITAL PRINT

ADVERTISING

MATERIALE
PROMOCIONALE

BRANDING

LED SCREEN

 **ZHAKIADVERTISING**



+383 (0)38 60 60 68
+383 (0)45 87 87 87
+383 (0)45 97 97 97

Highway Prishtina - Shkup 6-th km
10000 Prishtinë, Kosovë
info@zhakiadvertising.com
www.zhakiadvertising.com



”UJKU I ÇELIKTË” VALIDON USHTARËT E FSK-së



Në muajin nëntor Forca e Sigurisë së Kosovës ka përmbyllur me sukses validimin e regjimentit të dytë të këmbësorisë.

Falidimi i njësive është një proces i gjatë i planifikimit, trajnimit, stërvitjes së personelit dhe mbështetjes logjistike me qëllim të realizimit të detyrave në përmbushje të misionit të FSK-së.

Manifestimi i validimit



është realizuar gjatë muajit nëntor në kuadër të Ushtrimit Fushor “Ujku i Çeliktë” bënë demonstrimin e operacioneve mbrojtëse, operacioneve sulmuese dhe kulminuan me operacionet e stabilitetit.

Në kuadër të këtij ushtrimi janë validuar Regjimenti i Dytë i Këmbëtorisë dhe Togu i Mbështetjes Luftarake të Policisë Ushtarake.

SHKOLLA DHE EDUKIMI IDENTITAR I NXËNËSIT SHQIPTAR NË DIASPORË

Shkruan: Nuhi GASHI

10 këshilla themelore të mësuesit pse fëmija yt duhet ta ndjekë mësimin e gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë.

Në shumë shkolla apo ambiente të përshtatura shtetesh ku punon e jeton mërgata shqiptare tashmë nxënësit shqiptarë mund ta ndjekin mësimin e gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare. Ky mësim ose është i integruar në sistemet vendore arsimore dhe zhvillohet nën përkujdesjen shtetërore, ose është rezultat i vetorganizimit kulturor-arsimor vullnetar të shqiptarëve. Kjo veprimtari në popull me respekt të veçantë njihet si Shkolla Shqipe.

Sado që njeriu në planetin Tokë ende nuk ka

zbuluar një formë më të mirë të përshtatjes e të zhvillimit identitar, mjerisht shumë pak nxënës shqiptarë, pa fajin e tyre, e ndjekin këtë mësim.

Ndiej përgjegjësi që, duke u mbështetur në përvojën time të gjatë në këtë fushë dhe atë prej punës së përditshme të mësuesit, të bashkautorit e bashkëkoordinatorit të dokumentit themelor kombëtar, që në gjuhën profesionale quhet kurrikul (dokumenti Shqipëri-Kosovë, 2018), kontributorit e krijuesit në fushë të teksteve e të materialeve të shumta mësimore, autorit të shumë hulumtimeve etj. t'i këshilloj veçmas prindërit si më poshtë:



1. Si prind e si patriot e ke për detyrë e të drejtë që të bësh të gjitha të mundshmet për mësimin e gjuhës amtare nga fëmija yt, sepse ajo (gjuha amtare shqipe) për shqiptarin nënkupton vetë identitetin personal e kolektiv kulturor e kombëtar. Së këndejmi, ajo, duke i lidhur të gjithë bërësit identitarë (kulturë, traditë, histori, gjeografi, art, trashëgimi etj.), e zhvillon fuqishëm e qëndrueshëm ndjenjën/vetëdijen e përkatësisë (etniciteti), respektivisht e ruan dhe e zhvillon identitetin kombëtar, ndihmon në integrimin më të lehtë e të natyrshëm në shoqërinë e vendit, ndihmon në integrimin apo riintegrimin në shoqërinë e vendit të prejardhjes në rast të kthimit, i jep forcë dhe e pasuron komunikimin ndërkulturor në një shoqëri dy ose shumë gjuhësore e kulturore, krijon mundësi të reja e të panumërta për zhvillimin personal në karrierë, punë etj.

2. Ta kesh gjithmonë në mendje se vendi e ambienti ku më së lehti e më së miri mësohen gjuha amtare dhe kultura kombëtare është shkolla. Është kështu, sepse në shkollë qasja është profesionale dhe ndërkommunikimi e ndërveprimi janë dinamikë. Pra, dërgoje fëmijën tënd me dëshirë e krenari në shkollë!

3. Çdo prind dëshiron që fëmija i tij të komunikojë sa më lehtë, sa më qartë e sa më saktë. Sigurisht që gjuha amtare, fillimisht për shkak të lidhjes emotive, e bën këtë më mirë se gjuha tjetër.

4. Ti, si prind, herë nga padija, herë nga dezinformimi, herë edhe nga 'këshillat' jo të rralla edhe të mësuesit a të mësueses së shkollës vendore apo të gjuhës tjetër, se gjoja mësimi i gjuhës amtare po e dëmtuaka gjuhën tjetër ose gjuhën e shkollës vendore, mund të lajthitesh dhe e privon fëmijën tënd pa të drejtë nga mësimi i gjuhës amtare shqipe, gjuhës, e cila në të vërtetë është pasuria më e çmuar e shqiptarit dhe tipari më i rëndësishëm i identitetit kombëtar shqiptar. Ngulite në kokë se dijetarët më të shquar në botë tashmë kanë vërtetuar se mësimi i gjuhës amtare është i domosdoshëm për shumë arsye dhe se ajo (gjuha amtare) ndihmon në mësimin e gjuhës tjetër dhe sigurisht e shton edhe suksesin e nxënësit në shkollë. Po kështu ndodh edhe në marrëdhëniet ndërmjet fushave të tjera të zhvillimit identitar, respektivisht ndërmjet kulturave.

5. Ti, që mendon se fëmija yt duke mësuar gjuhën amtare sikur po ngarkohet tepër, mos harro se shkenca tashmë ka vërtetuar se fëmija është i zoti që në të njëjtën kohë t'i mësojë deri në 7 gjuhë, pa e dëmtuar gjuha gjuhën. Pra, përmes një ndërveprimi dinamik gjuha e ndihmon gjuhën.



6. Alfabetizimi (mësimi i shkrim-leximit) i fëmijës, nëse jo fillimisht për shkak të rrethanave të ndryshme me dhe në gjuhën amtare, së paku duhet të ndodhë paralelisht me gjuhën e vendit pritës.

7. Gjuha amtare dhe kultura kombëtare natyrshëm e ndihmojnë zhvillimin intelektual të fëmijës tënd. Fëmija bëhet shumë më i aftë, e zhvillon gjykimin e tij, bëhet më kritik, më i lirë e më i pavarur, bëhet më kërkues e krijues.

8. Duke qenë se gjuha amtare e kultura kombëtare (lexo: Shkolla Shqipe), duke qenë komunikimi më i dashur e më i afërt me zemër e nga zemra (lidhja emotive), është pasuri e pazëvendësueshme personale e kolektive dhe ndikon drejtpërsëdrejti në ruajtjen e kultivimin e tipareve më të shëndetshme të trashëgimisë kulturore, kombëtare, materiale e shpirtërore, ndër breza.

9. Mos harro se gjuha amtare, si ty, si fëmijës tënd, të ofron të mira si në familje, si në shoqëri. Me të e përmes saj edhe lidhjet shtojnë peshën e mirëkuptimit, dashurisë, solidaritetit, mirësisë etj.

10. Nëse i kthehesh kujtesës kolektive shqiptare, nëse kërkon të dish më shumë se si e panë dhe si e çmuan gjuhën shqipe njerëzit më të ditur të kombit shqiptar, do të gjesh se asaj i kënduan mendjet e ndritura të më të mëdhenjve, duke filluar me Naimin, Mjeden, Fishten, Lasgushin, Kadarenë etj. Nuhi Gashi është ekspert i pensionuar i arsimit në Kosovë. Ai drejtoi Zyrën për arsimin në diasporë në Ministrinë e Arsimit në Kosovë dhe shërbeu për 5 vjet si mësues i komunitetit shqiptar në Berlin.

12 PROPOZIME TË MËSUESIT SE ÇKA DUHET TË VIZITOHET NË **ATDHE**

Gjysma apo mbi gjysma e shqiptarëve jetojnë e punojnë në diasporë, apo mërgatë. Pra, në njëfarë mënyre para syve tanë po krijohet apo tashmë është krijuar “Shqipëria e dytë”.

Dhe, që ajo të zhvillohet sa më shëndetshëm dhe në raporte mbrothësie me të mirëfilltën (brenda kufijve të Atdheut), problem të parë e ka ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit kombëtar/kulturor. Veçmas te brezat e rinj (te fëmijët dhe të rinjtë e të rejtat), të cilët duke jetuar e duke u zhvilluar brenda një sistemi dy e shumëgjuhësor e kulturor, rrjedhimisht ballafaqohen me procese të ndryshme ndërvepruese apo edhe interferuese, si integrim, përshtatje, inkulturim, akulturim, dekulturim, asimilim etj.

Një formë e përkujdesjes identitare dhe shumë e parapëlqyer prej fëmijëve dhe të rinjve është njohja me trashëgiminë kombëtare për së afërmi; duke e vizituar atë, duke e eksploruar në formate të ndryshme. Zakonisht brenda një sistemi arsimor më të zhvilluar është shumë i njohur ekskursioni mësimor, por në kushtet shqiptare kjo formë, për fat të keq, është shumë pak e zhvilluar[1]. Dhe, sigurisht plotësimi, aq sa është e mundur, u përket familjes dhe prindërve. Kjo i bie që ti, si prind i ndërgjegjshëm që je, e ke për detyrë që vizitat në Atdhe t'i planifikosh me përgjegjësi sa më të madhe dhe me përmbajtje sa më të dobishme e tërheqëse për edukimin identitar të fëmijës tënd. Dijetarët e shkollës dhe të edukimit kaherë kanë vërtetuar se këto ndërmarrje janë shumë të dobishme dhe atë për shumë arsye:

- kur planifikohen e realizohen mençurisht, fëmijët i parapëlqejnë shumë;
- edukimi/mësimi ndodh aty për aty dhe është i drejtpërdrejtë e me rol aktiv të fëmijës;
- emocioni që krijohet siguron qëndrueshmërinë e mësimi; pra ajo që mësohet zor se do të harrohet;
- ndërveprimi është i shumanshëm dhe fëmija ndodhet në rol të subjektit (merr pjesë në planifikim, në realizim, përfiton prej tij).

JA NJË LISTË PREJ 12 PROPOZIMEVE TË PARA E SA MË SHËNJUESE TË MËSUESIT, SE ÇKA DUHET VIZITUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE:



1. Tiranë: Muzeu Historik Kombëtar, Sheshi 'Skënderbe' etj.



4. Qytete nga katalogu i UNESCO-s: Berati, Gjirokastra, Butrinti.



7. Krujë e Lezhë: Muzeu Historik i Skënderbeut dhe Kalaja e Krujës, Kisha e Shën Kollit (Mauzoleu i Skënderbeut) në Lezhë.



10. Shkodër: Muzetë e ekspozitat e ndryshme (Marubi), Rozafa, liqeni etj.



2. Prishtinë: Muzeu i Kosovës, Monumenti i Pavarësisë "New Born", Sheshi "Nëna Terezë" etj.



5. Vlorë: Shtëpia e Pavarësisë etj.



8. Prekaz: Kompleksi Memorial i Familjes Jashari (orë historie).



11. Korçë: Muzeu i shkollës së parë laike shqipe, qendra e qytetit dhe arkitektura origjinale, muzetë e shumta etj.



3. Shkup: Çarshia e vjetër, monumenti i Skënderbeut, Kalaja etj.



6. Durrës: Amfiteatri, Muzeu Arkeologjik etj.



9. Prizren: Kompleksi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit etj.



12. Ulqin: Kalaja e Ulqinit, njohja me historinë shqiptare etj.

E gjithë kjo ndërmarrje, që mund të organizohet edhe si program familjar, me sa më shumë pjesëmarrje, mund të realizohet brenda një jave, duke i shtuar edhe njohjen me trashëgiminë tjetër materiale e shpirtërore (bukuritë e pasuritë natyrore, monumentet e artefaktet e shumta, shijimi i kuzhinës kombëtare etj.).



“REPORTING HOUSE”, MUZE I JASHTËZAKONSHËM I HISTORISË SË KOSOVËS NË QENDËR TË PRISHTINËS

Mbi 5000 vizitorë e kanë vizituar muzen unik “Reporting House”, i cili është hapur në Kosovë për të treguar historinë moderne të Kosovës, rezistencën e viteve të 80-ta dhe të 90-ta në Kosovë.

Ky muze, “Shtëpia e Gazetarëve”, është i hapur nga e marta deri të shtunën, prej orës 10:00 deri në orën 18:00, në ish-Shtëpinë e Mallrave “Gërmia” në Prishtinë, te statuja e Skenderbeut, në shesh.

Jeta Xharra, gazetare, por edhe realizuese e këtij muzeu (që kishte punuar gjatë luftës për BBC), e ka marrë iniciativën për t'i digjitalizuar 30 orë materiale të


medieve të huaja, të cilat kanë raportuar për Kosovën, dhe ka folur enkas për revistën e “GP aviation” rreth këtij muzeu.

“Kanë kaluar 25 vjet pas lufte dhe ka ardhur koha që të luftojmë kundër korrupsionit e padrejtësive, të luftojmë harresën për atë që ka ndodhur në vendin tonë. E kemi hapur këtë muze modern, i cili, në formë shumë bashkëkohore, pa patetizëm, e shënon kontributin e popullatës civile për lirinë që Kosova e gëzon sot”, tha Xharra për GP.

Duke shënuar një çerekshkull nga përfundimi i luftës në Kosovë, ekspozita REPORTING HOUSE u ofron publikut vendor dhe vizitorëve të huaj një pasqyrim të hollësishëm të luftës sonë evropiane që përmbylli shekullin e 20-të.

E prodhuar nga BIRN Kosova, KALLXO.com, Biallja e Prishtinës dhe Paper Gallery, ekspozita prezanton punën e gazetarëve, fotografëve dhe artefakte të punonjësve të medieve, punë këto që vendosen krahas veprave të artit bashkëkohor që reflektojnë mbi ndikimin e luftës në dekadat që pasuan.

Ekspozita e REPORTING HOUSE u mundëson vizitorëve të udhëtojnë në konfliktin që po vlonte gjatë viteve 1990, nga i cili lindi lëvizja guerile e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që më vonë shpërtheu në luftë, në vitet 1998-1999, dhe kulmoi me 11 javë të sulmeve



ajrore të NATO-s, që çuan në çlirimin e Kosovës dhe në pavarësinë e saj në vitin 2008. Ekspozita shpalos draftin e parë të kësaj historie të shkruar nga gazetarët dhe demonstroi rolin qendror që e ka luajtur media, krahas interpretimeve artistike të mëvonshme të kësaj historie. Publiku ftohet që të kuptojë më tej historinë e jashtëzakonshme të Kosovës, ndërsa ekspozita është e hapur për bashkëpunim, për zhvillimin e saj të mëtejshëm.


Ekspozita prezanton vepra të artistëve që vijnë prej vendeve të ndryshme dhe emra të njohur nga bota e artit, si Anri Sala nga Shqipëria, Adrian Paci nga Shqipëria, Goncalo Mabunda nga Mozambiku, Lala Meredith Vula nga Anglia, Zhana Kadyrova nga Ukraina, Lana Cmajcanin nga Bosna dhe Hercegovina, Olafur Eliasson nga Islanda-Danimarka, Laura Imami nga Anglia dhe Besa Llugini, e deri tek artistët e rinj, si Vullnet Jakupi dhe Vita Kasapolli, nga Kosova.


Gazmend Ejupi, kurator i kësaj ekspozite dhe profesor i artit në Universitetin UBT, ishte ideator i kombinimit të artit modern me gazetari, gjë që e bën kaq unike këtë ekspozitë.



“Kemi kombinuar materialet e gazetarëve, fotografitë dhe videot e tyre me punime të artit bashkëkohor, që mirret me temën e përvojës së refugjatëve dhe luftës në vendet e tjera të botës. Thjesht përvojën tonë lokale të rezistencës e kemi bërë përjetim më reflektiv në këtë ekspozitë, duke i kuruar punimet e artistëve shumë të njohur ndërkombëtarë të ekspozohen në qendër të Prishtinës, me një hapësirë komplet të re kulturore”, tha Ejupi.

Si pjesë e kësaj ekspozite prezantohen rreth 150 storje televizive, të rrjeteve televizive botërore që janë transmetuar me xhirime për Kosovën, ndërmjet viteve 1992 dhe 1999, nga BBC, Das Erste (TV publik gjerman), Nippon TV, NHK (TV publik japonez), RTE (TV





publik irlandez), EO 2 Vandaag (TV publik holandez), Tele 5 (TV spanjoll) dhe Frontline Television News. Këto reportazhe promovojnë punën e gazetarëve, fotografëve, operatorëve të kamerave dhe përkthyesve e producentëve lokalë që punuan në to.

Kontribuesit në këtë ekspozitë janë Jeremy Bowen, Ben Brown, Ilaz Bylykbashi, Thomas Dvorzak, Alan Chin, Donika Shahini, Paul Lowe, Max Stahl, Ridvan Slivova, David Loyn, Jehona Lushaku, Besnik Mehmeti, Nik

Millard, Andrew Testa, Pal S. Refsdal, Flaka Surroi, Hazir Reka, Marija Ristiç, Fred Scott, Eliza Hoxha, Vaughan Smith, Nora Weller, Sean Whelan, Goran Tomaseviç, Sami Mustafa, Alban Bujari, Linda Gusia, Eki Rrahmani, Gazmend Avdiu, Srebrenica Memorial Center, Anibar, Koha Ditore, RTK dhe Oral History Kosovo.

Sfidat, me të cilat u përballën gazetarët që mbuluan luftën në Kosovë, rezonojnë edhe sot e kësaj dite, kur këtyre gazetarëve u duhet të mbulojnë

PËRPARIM RAMA, KRYETARI I PRISHTINËS

Këtu mund t'i shihni shumë prej incizimeve që i kanë bërë gazetarët vendorë dhe ndërkombëtarë, mund të shihni kontributin e 'fikserave' apo producentëve lokalë që kanë punuar në kohë të luftës për t'u treguar medieve ndërkombëtare ku po ndodh krimi dhe kanë arritur t'i raportojnë botës atë që ndodhte në Kosovë.

Në këtë ekspozitë tregohet një trashëgimi, edhe pse e hidhur, jona. Histori e rëndë, nëpër të cilën ka kaluar populli ynë, duke filluar prej grevës së minatorëve, kur kanë kërkuar trajtim të barabartë. Pastaj përpjekjet e popullit tonë, njëherë përmes paqes me Ibrahim Rugovën dhe në fund përmes UÇK-së dhe forcave të NATO-s,

që në fund kanë rezultuar në atë që ne mund ta gëzojmë, lirinë tonë.

Ata na kanë mundësuar që ne tani të jemi përgjegjës për të ardhmen tonë, të ëndërrojmë, të planifikojmë e të tregojmë si duhet të jetë e ardhmja jonë. Ne e jo dikush tjetër.



lufrat në Ukrainë, Gaza, Sudan e Etiopi, duke u përballur me propagandën dhe dezinformimin e zmadhuar nga mediet sociale.


Reporting House do të hapet në Shtëpinë e Mallrave të Prishtinës "Gërmia", që për herë të parë shndërrohet në hapësirë kulturore. Këtu dhe në dy hapësira të tjera, në Hamamin e Prishtinës dhe Paper Gallery, Shtëpia e Gazetarëve synon të krijojë ambient për përsiatje, dialog dhe katarzë, duke nderuar kujtimin për ata që kanë pësuar nga lufta në Kosovë dhe avokon për një të ardhme pa luftë.

Ekspozita është realizuar nga Jeta Xharra dhe kuruar nga Gazmend Ejupi.

Pjesa më e madhe e materialit televiziv arkivor dhe artefakteve janë dhuruar nga Vaughan Smith nga Frontline News Television, që punoi në Kosovë në vitet 1998-1999.

Kontributin kryesor për transformimin e hapësirës në këtë ndërtesë e ka dhënë Komuna e Prishtinës, e cila ka investuar në infrastrukturën e muzeut, ndërsa donatori kryesor i kësaj ekspozite është Ambasada Holandeze.

"GP Aviation" dhe "Prishtina Ticket" i kanë sponsorizuar udhëtimet e gazetarëve dhe artistëve që kanë kontribuar në këtë ekspozitë.





PRODUKTI NGA KOSOVA QË MBULON 6 TREGJE BOTËRORE

E themeluar në vitin 1985, kompania “Liri”, nga Prizreni, është shndërruar në njërin prej prodhuesve dhe eksportuesve më të mëdhenj të ëmbëlsirave, produkteve të çokollatës, bonboneve dhe biskotave.

“Liri” është brend, i cili ka arritur të krijonë 121 produkte, të cilat tregtohen në 6 vende të botës dhe dominon tregun e Kosovës me shumë produkte. Kompania arrin të prodhojë rreth 18 tonë produkte ushqimore në ditë, të cilat njihen për cilësinë e lartë të tyre. Produkti “Sempre”, njëri nga brendet e biskotave, është prej prodhimeve më të shitura në vend dhe ka konkurruar me brendet më të fuqishme botërore të biskotave për fëmijë dhe të rritur. Llokumet “Liri”, të njohura për cilësinë e tyre, janë brende që gjenden në secilën familje të Kosovës.

Produktet e çokollatës, si “Praline” apo “Wafel”, po ashtu janë prodhimet që kanë gjetur një treg të lartë në vend dhe në rajon.

Si prodhohen produktet

Baza e kompanisë është në Rajonin e Prizrenit, ndërsa fabrikat moderne kanë kontroll të lartë të cilësisë. Portfolio me mbi 121 produkte.

Për të garantuar cilësinë, “Liri” u është nënshtruar mekanizmave ndërkombëtarë të certifikimit. Fabrikat



dhe produktet janë të certifiuara me ISO 9001-22000 dhe HACCP, standarde këto më të lartat të prodhimit të produkteve ushqimore.

Kompania tashmë ka zgjeruar hapësirat prodhuese me investimet e reja, të cilat kanë krijuar një hapësirë prodhuese prej 10 mijë m².

Ku e gjejmë produktin

Prodhimet e “Liri” me brendet e saj gjenden në të gjitha zonat e Kosovës, në tregun e Shqipërisë dhe në tregun ballkanik. Falë certifikimit dhe zbatimit të standardeve të kualitetit, kompania ka arritur të eksportojë edhe në vende të BE-së. Momentalisht, kompania arrin të eksportojë në Gjermani, Zvicër, Suedi, Itali dhe Britani të Madhe.

LIRI
Since 1985

Vitamina • Minerale • Hekur • Proteina
Ca Fe B₆
E C B₁
B₂ B



Sempre

Rritemi së bashku me minerale dhe vitamina.

Biskotat Sempre janë të prodhuara nga përbërës të ushqyeshëm, duke i siguruar fëmijës tuaj vitamina dhe minerale thelbësore.

Duke kafshuar dhe përtypur biskotat Sempre, më të vegjlit tuaj stimulojnë mishin e dhëmbëve dhe lehtësojnë daljen e dhëmbëve të parë.



Një porcion (100g) SEMPRE biskota përmban:

Energji	Proteina	Sheqer	Yndyrna	Natrium
343 kcal	9.0 gram	24.13 gram	10 gram	0.3 gram
18%				



Vlera mesatare e rekomanduar për fëmijë në bazë ditore për konsumim prej 1800 kcal



PRISHTINA, QYTETI KU PËRJETOHET JETA E NATËS

Prishtina renditet në mesin e qyteteve me jetën më të pasur të natës.

Për gjatë 365 ditëve të vitit, sheshet, baret, klubet dhe diskotekat janë hapësira në të cilat mijëra qytetarë zbardhin mëngjesin në ndejat e paharruara.

Ndër arsyt kryesore pse turistët që e vizitojnë Prishtinën bien në dashuri me këtë qytet e rikthehen prapë dhe pse prishtinasit nuk largohen asnjëherë janë energjia, dashuria, mikpritja, gjallëria dhe jeta e natës. Kryeqyteti i Kosovës njihet më së miri për rininë e gjallë dhe plot jetë, që ndër vite ka bërë diferencimin sa u përket jetës së natës dhe muzikës, krahasuar me vendet e tjera fqinje.

Që nga paslufta, Prishtina ka evoluar sa i përket diversitetit kulturor, me ngjarje të shumta. Jeta e natës është ajo që e mban popullin aktiv. Larg nga hallet e përditshme, qytetarët mundohen që të mërkurave, të premteve dhe të shtunave, të vizitojnë disa nga vendet më të njohura.

Rinia e Prishtinës është e aftë të ofrojë ndryshime, të përshtatet në grupime e komunitete të ndryshme dhe të pranojë trendet e reja, të cilat i ka inkuadruar mjaft mirë në rutinën e jetës së natës.

“Soma Book Station” është një nga bar/kafet e njohura. Muzika, oborri i përpasmë dhe i pasmë, interieri i kuruar në detaje dhe menyuja e ushqimit, bëjnë që qytetarët ta frekuentojnë çdoherë. Netët me muzikë, nën ambientet e “Soma Book Station”, ofrojnë atmosferë dhe momente tejet të veçanta.

Rruga “Fehmi Agani” në Prishtinë njihet më së miri për “Kafet e Vogla”. Afër Qeverisë së Kosovës dhe Ambasadës së Kroacisë janë lokalet më të zhurmshme në vend, por shumë të dashura nga qytetarët. “Monroe”, “Large Bar”, “Che Bar” dhe “Miaq Pub” janë ndër më të njohurat për muzikën me DJ lokalë dhe të huaj.

Të gjithë ata që e vizitojnë Prishtinën, pa diskutim, janë mirë të informuar për rrugicën e njohur si “Kafet e rakisë”. Kjo rrugicë, në të cilën





nuk qarkullojnë automjetet, është e mbushur plot me lokale të vogla, të cilat mirëpresin grupe shoqërisht, për të provuar pijet alkoolike më të njohura në Kosovë, të tilla si rakia e birrat.

Një risi në kryeqytet këtë vit ka qenë edhe “Noya”, një tarracë avangarde, e cila ka sjellë një frymë të re në gastronomi dhe evenimentet e natës. Që nga fillimet e hapjes së këtij lokali, printet me trëndafila qenë marketingu më i mirë për biznesin, pasi që shfaqeshin kudo, në çdo storje të rrjeteve sociale.


Të tjerët, që dëshirojnë muzikë e ndeja, mund të vizitojnë baret afër ndërtesës “Rilindja”: “Bamboo bar”, “Apartment” dhe “Lunch i Vogël”, të cilat janë atraksioni i ahengut në këtë rrugë.

Prishtina njihet si qyteti që jetën e natës e ka të rregulluar me orë dhe transferim të njerëzve nga një zonë në tjetrën.

Pas disa pijeve në baret apo lokale brenda qytetit, ndjekësit e natës janë edukuar që të vazhdojnë ndejën në pubet dhe diskotekat e qytetit. Në to ndeja vazhdon deri në mëngjes.

“Zone Club” është një nga diskotekat më të njohura në Prishtinë, për muzikën alternative dhe komerciale, jo vetëm nga artistët lokalë, por edhe ata ndërkombëtarë. Së fundi, me trendin e muzikës elektronike, “Zone” ka bërë një diferencim sa u përket emrave që i ka sjellë për të performuar, duke bërë që shumë të huaj ta vizitojnë Prishtinën enkas për ta. Solomun, Deborah De Luca, Priku, janë vetëm disa nga emrat e njohur që kanë performuar në këtë vend.

“Gate Club” është klubi më i ri në kryeqytet, por shumë i dashur për vendësit e rinisë shqiptare nga diaspora e Kosovës. Me një atmosferë të ngrohtë e performues të njohur të zhanreve të ndryshme,



“Gate Club” zë një vend të rëndësishëm në Prishtinë.

Kur flasim për muzikën elektronike, Prishtina e ka përqaftuar mjaft mirë këtë ritëm, duke filluar nga evenimentet e mbajtura në “Rilindje”, vendi ku në vitet 80’ dhe 90’ shtypej gazeta. Dekada pas, ky vend për rininë e pasluftës njihet për ndejat e “Hapësirës” dhe vazhdon të jetë një vend atraktiv për dëgjuesit e muzikës elektronike.

Për të gjithë adhuruesit e ndejave ‘Servis’, në Prishtinë për muzikë elektronike të përzgjedhur organizatorët kanë hapur lokalin “Servis Fantazia”. Bari vazhdon të tërheqë të rinjtë, vend të cilin mund ta frekuentojnë çdo ditë.

Prishtina nuk i anashkalon as ata që e pëlqejnë muzikën rock. “Zanzi Jazz Bar” është një nga klubet më të vjetra që i ka mbijetuar kohës. Një hapësirë e vogël, me interior “old school”, sjell nostalgji nën tingujt e muzikës rock, rock alternativë dhe jazz.

Nga baret plot gjallëri, kafenetë plot atmosferë e ngrohtësi, e deri te ngjarjet e ndryshme kulturore, jeta e natës në Prishtinë ka diçka për të ofruar për të gjithë, duke e bërë qytetin tonë një destinacion vërtet mikpritës. Jeta e natës, e gjallë dhe e larmishme e qytetit tonë, shërben jo vetëm si një qendër argëtimi, por gjithashtu nxit një ndjenjë komuniteti dhe përfshirjeje.

MISHI I KECIT, PJESË E KUZHINËS TRADICIONALE SHQIPTARE

Në të gjitha trevat shqiptare, mishi i kecit është pjesë e gatimeve tradicionale të vendit. I shërbyer veçanërisht për festa, mishi i kecit gatuhet në mënyra të ndryshme, varësisht nga zona dhe kultura e komunitetit.

Përgatitja e tij pasqyron zakonet dhe traditat e ndryshme të rajoneve në Shqipëri. Ja disa nga mënyrat tradicionale dhe rastet kur mishi i kecit gatuhet:

Mishi i kecit në hell

Kjo është një nga mënyrat më tradicionale për të gatuar kecin. Në prushin e përgatitur nga thëngjilli, apo drutë e zjarrit, keci piqet për disa orë, duke marrë një shije të veçantë.

Varësisht nga zonat gjeografike, marinimi i kecit në hell dallon nga veriu në jug. Në disa zona përdoren mëlmesa të ndryshme, ndërsa më tradicionalja është spërkatja me lëng limoni dhe kripë. Sipas kësaj recete, keci vendoset në një hell prej druri dhe piqet mbi zjarr të hapur. Mishi spërkatet me kripë dhe lëng limoni gjatë pjekjes për të ruajtur shijen dhe lagështinë.



piper të zi dhe vaj ulliri. Tava piqet për disa orë dhe ka një shije të veçantë, të cilën e fiton gjatë procesit të zierjes dhe pjekjes. Kjo recetë përdoret zakonisht gjatë drekave festive ose në Bajram dhe mishi i kecit simbolizon bujarinë dhe mirësinë.

Keci me pilaf (Tava e kecit)

Në disa zona, veçanërisht në jug të Shqipërisë, përgatitet tava e kecit me oriz dhe erëza. Lëngu i mishit përdoret për të gatuar orizin, duke i dhënë një shije të pasur dhe aromë të veçantë.



Mish keci me qepë

Keci gatuhet edhe në pjesë më të imëta për të krijuar qebapë të ngjashëm me gatimet tradicionale turke. Në disa zona të Shqipërisë, mishi i kecit pritet në copa të vogla dhe gatuhet me qepë të karamelizuara, salcë domatesh dhe erëza lokale. Kjo recetë është shumë popullore gjatë dimrit, duke sjellë ngrohtësi dhe shije të thella.



Keci i pjekur në furrë, me patate

Një tjetër gatim i dashur është keci i pjekur në furrë, shpesh i shoqëruar me patate ose perime të tjera. Në këtë recetë tradicionale, mishi i kecit përzihet me erëza, si rigon, hudhër,

Paidhaqet e kecit

Pa dyshim, njëra nga recetat më të shijshme të gatimit të kecit është gatimi i brinjëve të kecit. Të prera në copëza të vogla, brinjët e kecit kanë një shije të veçantë dhe konsumohen lehtë, sidomos në tavolina festive. Përgatitja e paidhaqeve të kecit është një proces që kërkon kujdes për të nxjerrë në pah shijen e veçantë të këtij mishi delikat. Recetat e gatimit janë të ndryshme në zonat gjeografike të vendit, mirëpo ajo më tradicionalja është me erëza vaj ulliri dhe lëngë limoni.

Sipas udhëzimeve të kuzhinierëve, gatimi nis me përzierjen e erëzave si rozmarina, kripa, piperi, speci dhe mustardi, në një enë bashkë me lëng limoni vaj të ulliri dhe hudhrave. Lëngu i krijuar marinohet më pas me brinjët e kecit, për rreth 2 orë, ndërsa pjekja mund të bëhet në furrë apo në skarë.



FROSTEA



**Frostea udhëton
bashkë me ty!**

LEGJENDA E KRESHNIKËVE SHQIPTARË

Tradita shqiptare nuk mund të njihet pa u njoftuar me legjendat dhe të bëmat e kreshnikëve.

Të përmbledhura në “ciklin e këngëve kreshnike”, legjendat flasim për të bëmat e heronjve që mbrojtën trojet nga armiqtë shekullorë të shqiptarëve.

Këngët e kreshnikëve janë legjenda, të cilat u kënduan qindra vjet më parë, zakonisht duke u shoqëruar me lahutë.

Personazhet kryesore të këngëve janë Muja, Halili, Gjergj Elez Alia dhe figurat mbinatyrore.

Muji dhe Halili janë dy luftëtarë, të cilët kanë fuqi të mëdha dhe luftojnë me pushtuesit gjatë gjithë jetës së tyre. Në legjendat e kreshnikëve ata përshkruhen me fuqi të mëdha mbinatyrore dhe me aftësi për të bërë veprime që njerëzit normalë nuk mund t'i bëjnë.

Figura tjetër e kreshnikëve është Gjergj Elez Alia. Ai është një luftëtarë i fortë, që edhe pse ishte plagosur në nëntë vende arriti të luftojë dhe të mposhtë pushtuesit.

Kreshnikët përshkruhen si njerëz të fortë, të urtë, dhe të besës.

Legjendat e kreshnikëve janë një pasqyrë e traditave, vlerave dhe botëkuptimit të shqiptarëve. Në përditshmërinë e tyre, kreshnikët komunikojnë dhe flasin edhe me figura të mbinatyrore, të cilat në legjendat shqiptare kanë emra grash dhe njihen si “Zanat e Malit dhe Orët e Malit”.

Zana e Malit

Zana e Malit është një figurë mitologjike në kulturën dhe folklorin shqiptar, që përfaqëson një shpirt mbrojtës të natyrës, veçanërisht të maleve. Zanat janë krijesa të mbinatyrore, shpesh të përshkuara si gra të bukura, të forta dhe të urta, të



lidhura ngushtë me mjedisin natyror dhe misteret e tij.

Zanat janë shpesh heroinat e këngëve epike shqiptare, ku shfaqen si aleate të heronjve, si Gjergj Elez Alia ose Muji e Halili. Ato u japin heronjve fuqi dhe ndihmë për të përballuar sfida të mëdha.

Ora e Malit

Ora e Malit është një figurë mitologjike dhe një simbol i rëndësishëm në epikën shqiptare, sidomos në këngët e kreshnikëve. Ajo paraqitet si një qenie e mbinatyrore që lidhet ngushtë me natyrën dhe me fatin e njerëzve, veçanërisht me fatin e heronjve si Gjergj Elez Alia, Mujin dhe Halilin.

Në ciklin e kreshnikëve, Ora zakonisht përshkruhet si një aleate e kreshnikëve, duke i ndihmuar ata në luftërat kundër armiqve të huaj ose kundër forcave të tjera të mbinatyrore, si kuçedrat.

Ajo është simbol i lidhjes së ngushtë ndërmjet njeriut dhe natyrës dhe mishëron fuqitë e tokës dhe të malit shqiptar.

“E BUKURA E DHEUT”

Na ishte një herë një mbret që kishte një vajze të vetme. Vajza ishte shumë e veçantë në bukurinë e trupit të saj, kishte dituri dhe ishte e urtë, prandaj i thërrisnin e Bukura e Dheut.

E kërkuan për grua shumë princa e kapitenë të ndryshëm, por jo, nuk pranonte të martohet.

I ati dhe njerëzit e shtëpisë bënë çdo gjë për t'i mbushur mendjen dhe një mbrëmje ajo i tha:

- Epo mirë, pra, do të martohem. Por, do të marr për burrë atë që do të fshihet dhe unë nuk do të mund ta gjej dot.

Kjo fjalë u hap gjithandej dhe princa e kapitenë të mirënjohur provuan të fshiheshin, por ajo i gjente me një dylbi që shikonte përtej qiellit, tokës edhe detit.

Një djalosh i varfër kishte dalë për të lypur jashtë fshatit të tij. Shkoi dhe ndaloi tek një gur pranë një lumi dhe aty pa në një gropë me ujë një peshk të bukur që po përplasej.

- Do e shpëtoj – tha djali me vete dhe e kapi peshkun e hodhi në lumë.

Peshku kërcëu dy-tre here nga gëzimi pastaj doli ne breg dhe i tha djalit:

- Faleminderit o mik, nuk kam për ta harruar kurrë të mirën që më bëre. Prandaj merre këtë guaskë dhe kur të kesh nevojë hidhe në ujë e më thirr dhe unë do të jem aty.

E mori djali i varfër guaskën dhe e futi në trastën e bukës, pastaj vazhdoi rrugën.

Në një vend pak më larg pa një shpend që kishte mbetur në një lak dhe përpiquej të shpëronte.

- Po e liron këtë shpend të shkretë, – tha djali me vete.

Pasi e liron shikon që shpendi ishte shqiponjë dhe para se të largohet në fluturim shqiponja shkuli një pupël nga krahu dhe ia dha djalit, e pasi e falënderoi i tha:

- Kur të kesh nevojë për ndihmë hidhe këtë pupël në qiell dhe me thirr dhe unë do të vij.

E mori djali puplën dhe e futi në traste.

Vazhdoi rrugën dhe pastaj takoi një dhelpër, e cila kishte rënë në kurth. Dhelpëra i tha:

- Mirë se vjen o kumbarë!

- Pa prit pak, – tha djali me vete, – nga dola unë kumbarë me dhelpëren? – dhe ia drodhi fjalën po në atë mënyrë e i tha: – mirë se të gjej mos kumbarë.

Kur dëgjoi fjalën e ëmbël, dhelpëra mori zemër dhe e vazhdoi bisedën:

- Nëse më shpëton, unë do të gjendem pranë kur të kesh nevojë.

- Po e shpëtoj edhe këtë se nuk i dihet si vjen puna, – thotë djali me vete.

Hapi kurthin dhe dhelpëra kërcëu jashtë, por para se të ikte hoqi pak lesh, ia dha djalit dhe i tha:

- Kur të kesh nevojë, digje leshin në zjarr dhe unë do të gjendem pranë.

E mori djali leshin dhe e futi në traste bashkë me sendet e tjera. Ec e ec dhe arriti në vendin e të Bukurës së Dheut. Atje dëgjoi fjalët që ishin hapur dhe tha me vete:

- Vetëm unë mund të fshihem atje ku e Bukura e Dheut nuk mund të më gjejë dot.



Shkoi djali dhe u paraqit në pallatin e mbretit dhe tha se donte të provonte edhe ai të fshihet. E bija e mbretit e pranoi edhe i dha tri ditë kohë.

Djali shkoi me vrap te bregu i lumit dhe hodhi guaskën në ujë. Peshku i vogël doli nga uji dhe e pyeti djalin se për çfarë kishte nevojë dhe ai i tha:

- A di ndonjë vend ku mund të më fshehësh?
- Të fsheh unë menjëherë. – i tha peshku i vogël dhe thirri një peshk të madh dhe e fshehu djalin në barkun e peshkut të madh edhe ai u zhduk dhe humbi.

E Bukura e Dheut mori dylbinë dhe e kërkoi ditën e parë në qiell, por nuk e gjeti. E kërkoi ditën e dytë në tokë por prapë nuk e gjeti. Ditën e tretë e kërkoi në ujë dhe në fund e gjeti në det.

- Të gjeta, – i tha e Bukura e Dheut, – por meqenëse qenke kaq i djallëzuar po të jap leje të fshihesh edhe një herë.

Atëherë djali mori puplën e hodhi në qiell dhe menjëherë erdhi shqiponja edhe e pyeti se çfarë kërkonte. Djali i tha se nëse dinte një vend ku mund ta fshihet dhe ajo i tha:

- Hip mbi shpinën time, – dhe u ngrit në fluturim e shkoi përmbi re.

E Bukura e Dheut mori dylbitë dhe filloi ta kërkonte. Ditën e parë pa në ujë, por nuk e gjeti. Ditën e dytë shikoi nëpër tokë, por nuk e gjeti. Ditën e tretë e gjeti në qiell përmbi re.

- Të gjeta edhe këtë herë, – i tha e Bukura e Dheut, – po meqë qenke dreqi vetë po të jap leje të fshihesh edhe një herë.

Djali nxori nga trasta leshin e dhelpërs dhe e dogji. Dhelpëra erdhi edhe e pyeti:

- Çfarë do nga unë?

- A di ndonjë vend ku mund të me fshehësh? – e pyet djali.
- Eja pas meje, – ia ktheu dhelpëra.

E mori me vete dhe e çoi në kopshtin e të Bukurës së Dheut. Sa herë që dilte nëpër kopsht për të shëtitur, e Bukura e Dheut linte në fillim të shkalleve një kokërr molle që nuk e lëshonte kurrë nga dora. Dhelpëra e mori mollën, e ndau në mes dhe i tha djalit të hynte brenda. Pastaj e ngjiti mollën dhe e la prapë te shkallët.

E Bukura e Dheut mori dylbinë dhe ditën e parë kontrollloi në qiell, por nuk e gjeti. Ditën e dytë e kërkoi në tokë, por nuk e pa në asnjë vend. Ditën e tretë dhe të fundit e kërkoi në ujë, por as aty nuk e gjeti. Atëherë mori mollën e futi në gji dhe plasi nga inati.

Pasi kaloi edhe dita e tretë djali doli nga molla dhe vajza e mbajtj fjalën dhe u martua me të.



GRATË QË SFIDUAN DHIMBJEN DHE FORCUAN EKONOMINË

Toka e Krushës është njëra nga zonat më të pasura të Kosovës. Dy fshatrat, Krushë e Madhe dhe Krushë e Vogël, pësuan tragjedi. Në vitin 1999, shumica e burrave të fshatit u vranë në Masakrën e Krushës. 24 vjet më pas, gratë e fshatit e kanë zhvilluar prodhimin dhe e kanë shndërruar zonën në njërin prej eksportuesve të mëdhenj të vendit.

Një nismë e vogël, e nisur 20 vjet më parë, është shndërruar në një model biznesi të suksesshëm nga Kosova.

Fahrije Hoti për 20 vjet e ka drejtuar Kooperativën Bujqësore “Krusha”, e cila sot prodhon 42 lloje të produkteve të përpunuara bujqësore.

Fahrija arriti të krijonte një kompani, e cila u garantoj zhvillim grave të veja të Krushës dhe ndërtoi brendin që sot eksportohet në shumë vende të Evropës. Çdo gjë nisi thjeshtë, nga shtëpitë e Krushës, ku nisi të zihet ajvari tradicional dhe të bëhej gati për t’u nxjerrë në treg.

“Tani në kooperativë kemi një infrastrukturë më të mirë, pra nuk jemi më sikur dikur, që kemi punuar nëpër shtëpi dhe pa kushte adekuate. Tani, ta them të drejtën, sa u përket kushteve të punës, na duket sikur jemi në vende të zhvilluara, si në Zvicër, apo në Gjermani, sa

i përket kushteve në të cilat tani jemi duke punuar”, thotë Fahrija.

Ajo thotë se kërkesat për treg janë më të mëdha sesa aktualisht arrijnë të prodhojnë dhe një pjesë e mirë e prodhimit shkon për eksportin.

“Aktualisht jemi duke u marrë kryesisht me përpunimin e ajvarit dhe po ashtu janë duke u përgatitur dhe realizuar ngarkesat për eksport”, thotë Hoti.

“ ÇKA PRODHOHET NË KOOPERATIVËN “KRUSHA” “Kooperativa prodhon 42 produkte, prej së cilave ajvarin, specat me kos dhe reçelet me kungull, me kumbulla apo edhe reçeli i misrit. Varësisht nga kërkesa në treg, ta shohim se sa do të kemi sukses edhe me këto produkte”, thotë ajo.

Në këtë kooperativë kryesisht janë të punësuarat gratë nga Krusha dhe nga fshatrat e komunat si Rahoveci dhe Prizreni. Siç rrëfen Fahrije Hoti, rritja e

stafit gjithmonë ka shkuar në mënyrë graduale, paralel me rritjen e tregut.

“Tash, për momentin, janë të punësuar 40 gra dhe tetë persona të tjerë jemi staf administrativ, në mesin e tyre janë vetëm katër burra/djem, kryesisht jemi gra. Ne punojmë 10 muaj në vit, për arsye se në muajin mars kryesisht merremi me ngarkesa, prillin e kemi pasiv, muajin maj përgatitemi dhe në fillim të qershorit vetëm startojmë me prodhimet tona”.

Bashkëpunimi me fermerët – eksporti në tregjet e vendeve të BE-së deri në SHBA

Falë zgjerimit të linjës prodhuese, nga viti 2016, kur filluan zhvendosjen në fabrikën e re, Hoti tregon se është rritur edhe numri i fermerëve me të cilët bashkëpunojnë, duke nisur nga fermerët lokalë nga Krusha e Madhe dhe nga vendet e tjera anekënd Kosovës, përfshirë edhe fermerët nga Shqipëria.

“Ne kemi fermerë pothuajse në gjithë trevën, anembanë Kosovës, me kultura të ndryshme. Kemi bashkëpunim jashtëzakonisht të mirë me fermerët, por shqetësuese është ikja e të rinjve, e cila ka bërë që të zvogëlohen parcelat me kulturat e perimeve. Kjo natyrisht që kushton për ne si përpunues, gjithsesi edhe për fermerët. Por jemi të kënaqur sa i përket bashkëpunimit me fermerët, edhe pse shumë herë prodhimi në fusha varet shumë nga kushtet klimatike. Kushtet klimatike ndikojnë dhe neve na duhet të importojmë një sasi të konsiderueshme të specit ‘babura’ nga Shqipëria”, thotë Hoti.

Ajo kujton kohën kur filluan produktet e tyre të turshive dhe të ajvarit në mënyrë artizanale, në vitin 2005, kohë kur kryesisht arrinin t’i shisnin produktet nëpër tregje dhe tutje u zgjeruan edhe me pjesëmarrjen e tyre nëpër panairë të ndryshme, në qytete të ndryshme të Kosovës, deri tek eksporti për herë të parë në vitin 2016.

“Të kthehem në vitin 2005, kur filluam tregun vendor, kryesisht me prezencën tonë nëpër panairë, pastaj nëpër dyqane dhe konsumatorë individualisht, që na vinin këtu. Vite me radhë kanë filluar kërkesat me eksport, prej vitit 2016, kohë kur kemi filluar hapat e parë në tregun e parë në Zvicër. Tash kryesisht jemi të shtrirë në vendet e Evropës dhe në SHBA. Kështu që 90% të prodhimit e eksportojmë, mbetet 10% në tregun vendor”, tregon ndërmarrësja Fahrije Hoti.

Hoti: Mërgimtarët janë konsumatorët më besnikë të produkteve tona

Hoti kujton pamjet gjatë kthimit të mërgimtarëve në vendet ku jetojnë dhe veprojnë, pasi rrezikonin duke marrë me vete gjatë kthimit turshitë, janë gjobitur nëpër kufijtë e vendeve të BE-së. Sipas saj, nga viti 2016 e tutje mërgimtarët, për të cilët ajo thotë se janë klientët



më besnikë të produkteve të tyre, nuk kanë nevojë të rrezikojnë më, sepse me produktet e tyre Kooperativa Bujqësore “Krusha” është e pranishme pothuajse në çdo vend të BE-së, përfshirë edhe SHBA-në.

“Ka qenë një trend kur kemi filluar ne edhe të gjithë mërgimtarët që shkonin tutje i merrnin turshitë me bure e kavanoza dhe fatkeqësisht nëpër kufij ua gjuanin në shporta të mbeturinave dhe i gjobisnin. Nga viti 2016, në të gjitha shtetet e Bashkimit Evropian, pothuajse janë prodhimet tona të pranishme dhe nuk kanë nevojë më mërgata jonë të rrezikojë duke i marrë me vete, kur tashmë i kanë atje, produktet tona.

“Ne u jemi falënderues për gjithë kontributin e bashkatdhetarëve tanë që jetojnë dhe veprojnë në diasporë. Menjëherë pas luftës na kanë ndihmuar, i kanë ndihmuar fëmijët pa prindër. E kanë dhënë djersën e vet, ndoshta i kanë lënë pa i plotësuar nevojat e familjeve, fëmijëve të tyre, dhe na kanë ndihmuar, për çka u jemi mirënjohës për sa të jemi gjallë ne dhe familjet tona. Ndihma e tyre vazhdon edhe sot, sepse ata janë konsumatorët më besnikë të produkteve tona anekënd shteteve ku jemi të pranishëm”, rrëfen ajo.

Rrugëtimi nga zyra me fotografi të familjarëve të zhdukur

Hoti kujton sfidat e para, që nga një zyrë me fotografoi të familjarëve të zhdukur filluan të prezantonin turshitë, pasi ishin të detyruara që si gra me burrat e vararë dhe zhdukur në luftë t’i mbanin familjet, t’i rrisnin fëmijët jetimë.

“E nisëm me një logo që e kishim për personat e zhdukur. Në 2003-2005 ne tërë ditën qëndronim nëpër rrugët e Prishtinës dhe të Prizrenit për t’u informuar për djemtë e burrat tanë se ku janë. Mirëpo, në fund të ditës ktheheshim nëpër shtëpi me duar bosh para fëmijëve tanë. Në vitin 2005 i mbjell vjehrrin do specat dhe fliste me fëmijët që t’i çojnë në treg, në Xërxë, mirëpo kush



t'i çonte, shin vrarë të gjithë burrat, kishte mbetur një fëmijë, më i madhi 12 vjeç. Unë isha grua pa burrë, qysh me dalë me plasu në treg dhe aty fillova me i qit nëpër kavanoza dhe i nxorëm në zyrë të shoqatës, e cila ishte përplot me fotografi të personave të pagjetur. Një zyrë të cilën ne gratë e Krushës e paguanim me vetëparticipim dhe aty filluam t' i ekspozonim edhe produktet tona, atëherë si shoqatë dhe jo si kompani", rrëfen ajo.

"Tutje kam filluar me biznes në bashkëpunim me GTZ në vitin 2010, na ndihmoi të themelojmë si kooperativë dhe kështu filluam t'i zyrtarizonim me barkode, me tiketa, produktet tona dhe filluam t' i plasonim nëpër tregun vendor. Fillimisht, qysh kemi mundur kemi shitur, duke filluar prej pazarit në Gjakovë, tutje prej panaireve. Ka ndodhur nuk na kanë lejuar të hyjmë në panair dhe kemi qëndruar te dera dhe i kemi prezantuar produktet tona", tregon Hoti.

Ajo tregon se, me gjithë sfidat, nuk u sprapsën asnjëherë.

"Nuk na kanë munguar vullneti, pozitiviteti dhe shkonim nëpër panaire, edhe pse ishim të dërmuar, kishim humbje të madhe në burra dhe në fëmijë. Asnjëherë nuk jemi dorëzuar, duke shiku të ardhme më të mirë për vete dhe fëmijët tanë jetimë".

Vështirësitë e gjetjes së tregut

Fahrije Hoti kujton se si ishte e detyruar që specat e konservuar t' i dërgonte nëpër tregje për t' i shitur, pasi nuk kishin ende produkte të prodhuara me tiketa dhe ambalazhim të duhur.

"Në vitin 2005 ne kemi shitur nëpër tregje me bure, pa produkte të ambalazuara, pra s' kemi pas mundësi tjera me i konservu, me i qit në kerr dhe me dalë në pazar në Gjakovë. Në atë kohë kisha edhe bletë dhe e qitsha në kombi e çoja vjehrrin në Gjakovë dhe i shiste

me bure. Por, me kalimin e kohës, me pjesëmarrja nëpër panaire, trokitja nëpër markete, u thosha 'kemi turshi' dhe çdo market që kemi kontaktuar na kanë sugjeruar se çfarë me bo tutje".

Si i thyen tabutë dhe i luftuan paragjykimet gratë e Krushës


Përveçse ishin në kërkim të familjarëve të tyre të zhdukur nga lufta, Fahrije Hoti tregon se gratë e Krushës duhej angazhuar për ta siguruar mbijetesën për fëmijët. Ajo kujton se nuk ishte aspak e lehtë, pasi shpesh gratë e veja ishin paragjykuar nga rrethi shoqëror, por asnjëherë nuk janë ndalur, pasi, siç thotë ajo, kishte një mision, që si grua e ve, me burrin e zhdukur, t' i rriste fëmijët.

"Paragjykimet, me të cilat jemi ballafaquar në fillim, kanë qenë ndër sfidat më të mëdha, ndoshta më shumë se vuajtja nga humbja e familjarëve tanë në luftë, më shume se munda gjatë prodhimit, për çka në fillim kishim shumë vështirësi. Paragjykimet e rrethit shoqëror kanë qenë shumë të rënda dhe na kanë lodhur ndoshta psikikisht më shumë sesa dhimbja që ne e kishim pasi dolëm nga lufta të shkatërruara e me burra të vrarë dhe të zhdukur", tregon ajo.

"Tërë ditën ke punu dhe ndoshta i ke fitu 50 euro dhe në fund të ditës iu ke ble fëmijëve bukë. Mirëpo, kur ke dëgju për etiketimet 'gratë pa burra çka janë t' u bo', kjo shpesh na ka lodhur dhe demoralizuar. Nganjëherë mendonim që edhe sot i shitëm këto turshi dhe më s' do të fillojmë në ditën tjetër. Mirëpo, kur u zgjonim në mëngjes patjetër duhej me punu, me rrugëtu. Sepse sikur të kishte trokitur dikush që të na thoshte 'që ju nuk keni me punu dhe ju keni me i rrit fëmijët, me i bo punët e shtëpisë, ne do t'jua japim pagën mujore'. Por, me 35 euro qysh t' i rrisësh tre, 5 apo 7 fëmijë. Pra, kjo ka qenë, sepse ne nuk dolëm nga qejfi në rrugë, dolëm nga zori për një jetë më të mirë", tregon Hoti.

Tutje ajo rrëfen se angazhimi në punë u ka ndihmuar ta tejkalojnë situatën e rëndë, nga e cila dolën nga lufta. "Kurrë nuk i harrojmë pasojat e luftës, mirëpo ne po e tejkalojmë dhimbjen me këtë punë. Si grua 29-vjeçare (1999), me burrin në listën e personave të pagjetur, me i rrit fëmijët me plot përgjegjësi, me i eduku, me i shkollu, edhe me martu një grua e vetme, pa përkrahjen e burrit, d.m.th. pa dy krahët, ka qenë shumë sfiduese. Por, paragjykimet, jo vetëm në Krushë, por në gjithë Kosovën, kanë qenë më të lodhshme se krejt puna dhe krejt mërzia që e kemi pasur dhe e kemi si pasojë e asaj që pësuar nga lufta. Por nuk jam dhe as nuk e kam kurrë ndërmend të dorëzohem".

"Mesazhi im për të gjitha gratë, edhe për ato në zonat rurale, me dhe pa shkollim: U bëj thirrje që të



gjitha mënyrat t' i shfrytëzojnë me e gjet vetën me punu dhe mos me u marrë me të tjerët. Më mirë ta bëjnë një punë kot sesa me qëndru kot e me u frymëzu negativisht”, thotë Fahrije Hoti.


Përkrahja nga donatorët

Hoti tregon se falë ndihmës së shumë donatorëve të huaj, institucioneve vendore, lokale dhe qendrore, me gjithë sfidat e shumta, Kooperativa Bujqësorë “Krusha” njihet përtej kufijve të Kosovës. Ajo shton se për historinë e grave të Krushës bota ka dëgjuar pikërisht nga kjo kooperativë.

“Fatbardhësisht kooperativa njihet në nivel botëror, jashtë kufijve tanë. Neve na kanë vizituar delegacione të ndryshme anekënd botës dhe këtu ata janë njohur me historinë e grave të Krushës. Janë njohur me historinë tonë, se qysh një grua kthehet pas rrugëtimit në Shqipëri, kthehet në Kosovë dhe e merr veten e nis të punojë një grua e ve, me dy fëmijë të vegjël, me burrin e zhdukur, e merr jetën në dorë dhe fillon të punojë në vendin e vet”.

Ajo thotë se nuk ka munguar ndihma nga organizatat ndërkombëtare, kryesisht kanë pasur ndihma nga Bashkimi Evropian, nga viti 2016, në fabrikën ku punojnë sot.

“Përkrahje kemi pasur nga GIZ-i, nga USAID-i, Ministria e Tregtisë dhe disa organizata joqeveritare dhe qeveritare, çdokush nga pak na kanë ndihmuar në rrugëtimin tonë dhe tani jemi duke e sfiduar veten që me qëndru në këmbët tona. Kemi sfida, pasi kemi investuar shumë në këtë objekt ku jemi tani, sepse kemi qenë vetëfinancuese me 55% këtu dhe kemi investuar në makineri mbi 100 mijë euro. Shpresojmë që në të ardhmen të



kemi bashkëpunime edhe me donatorë të tjerë, përfshirë institucionet tona, dhe të vazhdojmë me angazhimin, rritjen e numrit të punëtorëve dhe të prodhimeve tona”, thotë ajo. “Edhe sot, kur të vij në fabrikë, e mendoj që mos jam duke shkuar në ndonjë punë tjetër – ndërmarrje tjetër, shpesh nuk e besoj që është krejt kjo një kontribut i disa grave që u zgjuan pas luftës dhe morën iniciativë për të punuar diçka. Dhe, sot janë shembull më i mirë edhe përtej kufijve të Kosovës, që gratë e veja e nisin nga hiqi dhe pas rrugëtimit ndër vite për me mbërrë ku jemi këtu sot. Puna për ne ka qenë shumë sfiduese, sepse kemi punuar nëpër oborre, pa kushte. Mirëpo, konsumatorët na besuan dhe kjo ka qenë motiv shtesë që me vazhdu”, përfundon rrëfimin Fahrije Hoti.

“ Në Krushë të Madhe të komunës së Rahovecit, në luftën e fundit 1998-1999, janë vrarë dhe masakruar 155 civilë dhe kanë rënë 22 dëshmorë. Në Krushë edhe më tutje janë mbi 60 persona që figurojnë të zhdukur.



POSSIBILITIES & PARTNERS

Empowering Your Brand

with Tailored

Marketing Solutions

Our Services

- ✓ Marketing
- ✓ Digital Marketing
- ✓ Public Relations
- ✓ Production
- ✓ Web Development
- ✓ IT Solutions

Shërbimet

- ✓ Marketing
- ✓ Marketing Dixhital
- ✓ Marrëdhënie me Publikun
- ✓ Produksion
- ✓ Zhvillim i Ueb-it
- ✓ Teknologji Informative

- ✓ TRANSFORMOJMË PREZENCËN TUAJ ONLINE
- ✓ REKLAMO BIZNESIN NË AEROPORTIN E PRISHTINËS ME OFERTËN MË TË MIRË
- ✓ REKLAMO BIZNESIN NË TELEVISIONE, RADIO DHE PORTALE ME OFERTË EKONOMIKE

CONNECT WITH US:

 www.pfp-ks.com

 +383 43 899 331

Mirësevini në Hotel Bonita në Golem, Kavajë!

Hoteli me 5 yje ofron pishina të brendshme dhe të jashtme, SPA, qendër fitnesi, plazh privat dhe restorant me kuzhinë cilësore.

Destinacioni ideal për pushime të paharrueshme!

Për rezervimet tuaja kontaktoni në:

+355 69 822 9985

www.hotelbonita.al



TRENDI MODERN I HOTELERISË

Mirësevini në Bonita Luxury Resort!

Një oaz luksi në Golem, Bonita ofron pushime të paharrueshme me AQUA PARK-un unik, katër pishina dhe plazhin rënor me shërbime të shkëlqyera në beach bar.

Relaks dhe argëtim në një ambient modern dhe tërheqës!

- ✓ Akomodime luksoze
- ✓ Kuzhinë e klasit botëror
- ✓ Relaksohuni dhe rigjallërohuni

Kontakt: →


+355 69 559 9916

www.hotelbonita.al





DENTFIX
ORDINANCA STOMATOLOGJIKE



Transform your confidence with our expert care!

We specialize in advanced dentistry and precision hair transplant solutions, combining cutting-edge technology with personalized treatments. From radiant smiles to revitalized hair, we're here to help you look and feel as best as possible.




@dentfix ks
+383 44 22 55 34
www.dentfix-ks.com
Ahmet Krasniqi Str. No 137,
Pristina, Kosovo

Prof. Asoc. Dr FEHIM HALITI



Part of DENTFIX GROUP



CARE & HAIR FIX
ESTHETICS & HAIR TRANSPLANT CLINIC



CARE & HAIR FIX
ESTHETICS & HAIR TRANSPLANT CLINIC